



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Ligji Nr. 04/L-211

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES FINANCIARE “ISTISNA’A”
DHE MARRËVESHJA PËR AGJENCINË “ISTISNA’A” PËR
FINANCIMIN E VAZHDIMIT TË NDËRTIMIT TË RRUGËS
MILLOSHEVË - MITROVICË, RRUGA M2, E LIDHUR NDËRMJET
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE BANKËS
ISLAMIKE PËR ZHVILLIM**

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të neneve 18 dhe 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

**LIGJ PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES FINANCIARE
“ISTISNA’A” DHE MARRËVESHJA PËR AGJENCINË “ISTISNA’A”
PËR FINANCIMIN E VAZHDIMIT TË NDËRTIMIT TË RRUGËS
MILLOSHEVË - MITROVICË, RRUGA M2, E LIDHUR NDËRMJET
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE BANKËS
ISLAMIKE PËR ZHVILLIM**

Neni 1
Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim që të ratifikojë marrëveshjen Financiare “ISTISNA’A” dhe Marrëveshjen për Agjencinë “ISTISNA’A”, e lidhur në mes të Republikës së Kosovës dhe Bankës Islamike për Zhvillim për Financimin e vazhdimit të ndërtimit të rrugës Milloshevë - Mitrovicë, Rruga M2.

Neni 2
Ratifikimi

Ratifikohet Marrëveshja Financiare “ISTISNA’A” dhe Marrëveshja për Agjencinë “ISTISNA’A”, e lidhur në mes të Republikës së Kosovës dhe Bankës Islamike për Zhvillim për Financimin e vazhdimit të ndërtimit të rrugës Milloshevë - Mitrovicë, Rruga M2, e nënshkruar më 22.05.2013 në Dushanbe të Tashkistanit.

Neni 3
Dokumentet e bashkëngjitura

Në anekset nr. 1 dhe 2 të këtij ligji është bashkëngjitur Marrëveshja Financiare “ISTISNA’A” dhe Marrëveshja për Agjencinë “ISTISNA’A”, e lidhur në mes të Republikës së Kosovës dhe Bankës Islamike për Zhvillim për Financimin e vazhdimit të ndërtimit të rrugës Milloshevë - Mitrovicë, Rruga M2.

Neni 4
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 04/ L-211
31 korrik 2013

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Jakup KRASNIQI

DOKUMENTACION LIGJOR
NË LIDHJE ME FINANCIMIN NGA
BANKA ISLAMIKE PËR ZHVILLIM ISTINA' A

EURO 15,410,000.00

NË FAVOR TË

REPUBLIKËS SË KOSOVËS

NË LIDHJE ME

FINANCIMIN E PROJEKTIT PËR PËRMIRËSIMIN
E RRUGËS M2 MILLOSHEVË-MITROVICË

MARRËVESHJE E ISTISNA’A

NË MES TË

REPUBLIKËS SË KOSOVËS

DHE

BANKËS ISLAMIKE PËR ZHVILLIM

PËR
FINANCIMIN E PROJEKTIT PËR PËRMIRËSIMIN E
RRUGËS M2 MILLOSHEVË–MITROVIC

Përmbajtja

Neni -1	PËRKUFIZIMET – INTERPRETIMI	4
Neni -2	NDËRTIMI DHE PRANIMI I ASETIT	7
Neni -3	PAGESA E ÇMIMIT TË SHITJES	8
Neni -4	PEZULLIMI, ANULIMI DHE NDËRPRERJA	10
Neni -5	PËFAQËSIMET	11
Neni -6	NGJARJET E DËSHTIMIT	112
Neni -7	DËMSPËRBLIMI	13
Neni -8	EFEKTIVITETI	14
Neni -9	HEQJE DORË	15
Neni -10	LIGJI MBIZOTËRUES – ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE	15
Neni -11	BASHKËRENDIMI DHE NJOFTIMET	16
Neni -12	TË NDRYSHME	16
Faqja e ekzekutimit:		18
Aneksi -I	PËRSHKRIMI I ASETIT	20
Aneksi -II	PËRSHKRIMI I PROJEKTIT	211
Aneksi -III	FORMA E OPINIONIT E AUTORITETIT KRYESOR LIGJOR DHE/APO GJYQËSOR E QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS	222

MARRËVESHJA ISTISNA'A

Kjo Marrëveshje është lidhur më 12/07/1434H (që korrespondon me 221/5 2013G) në mes të Republikës së Kosovës si blerës (këtu e tutje **“Pranuesi”**) dhe Bankës Islamike për Zhvillim si shitëse (këtu e tutje **“Banka”**).

Pranuesi dhe Banka në mënyrë të përbashkët referohen si **“Palët”** dhe në mënyrë individuale si **“Pala”**.

Ndërsa,

- A) Pranuesi ka kërkuar nga Banka që të financoj ndërtimin e punimeve të përcaktuara në Aneksin –I (këtu e tutje referohet si **“Aseti”**) përmes Istisna's për t'u shfrytëzuar përmirësimin e rrugës kryesore M2 Milloshevë – Mitrovicë ashtu siç përshkruhet në Aneksin – II (këtu e tutje referohet si **“Projekti”**);
- B) Bordi i Drejtorëve Ekzekutiv i Bankave më ____/____/____ H (që korrespondon me / ____ /2013G), ka aprovuar ndërtimin e Aseteve për Projektin në një shumë që nuk tejkalon €15,410.000.00 (pesëmbëdhjetë milion e katër qind e dhjetë mijë euro) përafërsisht që është ekuivalent me ID13,200,000.00 (trembëdhjetë milion e dy qind mijë dinar islamik) (këtu e tutje referohet si **“Shuma e Aprovuar”**);
- C) Çmimi i Shitjes do t'i paguhet Bankës nga Pranuesi për 15 (pesëmbëdhjetë) vite pas Periudhës së Zhvillimit prej 3 (tre) viteve. Këto kushte të përgjithshme u janë komunikuar Pranuesit, dhe janë pranuar nga Pranuesi;
- D) Marrëdhënia në mes të Bankës dhe Pranuesit është ajo e shitësit dhe blerësit në përputhje me parimet e Sheriatit Islamik ashtu siç interpretohen nga Akademia Islamike Fiqh dhe shpallur në standardet e Sheriatit të publikuara nga Organizata për Kontabilitet dhe Auditim për Institucionet Islamike Financiare (AAOIFI); dhe
- E) Palët e kanë nënshkruar Marrëveshjen Kornizë të asaj date të statusit dhe bashkëpunimit në lidhje me veprimet e Bankës në Republikën e Kosovës.

Prandaj, tani, Banka dhe Pranuesi më këtë pajtohen si në vijim:

Neni -1 PËRKUFIZIMET – INTERPRETIMI

- 1.1 Në këtë marrëveshje, përveç nëse konteksti kërkon ndryshe, termat si në vijim do të kenë kuptimin e atyre që jepet kundrejt tyre sikur këtu të shënuar poshtë:

Marrëveshja e Agjencionit:

Marrëveshja e asaj date në mes të Bankës dhe Pranuesit, me të cilën Pranuesi do të veproj si agjent i Bankës në përzgjedhjen e Kontraktuesit dhe konsulentit, dhe për mbikëqyrjen e ndërtimit të Asetit.

Shuma e aprovuar:

Shuma e saktësuar në përshkrimin - B lartë.

Aseti:	Punët e përshkruara në Aneksin - I.
Ditë pune:	Çdo ditë në të cilën bankat janë zyrtarisht të hapura për punë në vend ku shuma apo shumat i paguhen Bankës nga Pranuesi në valutën në të cilën një pagesë e tillë do të paguhet.
Kostoja kapitale:	Kostoja totale e ndërtimit të Asetit e cila do të përfshijë Çmimin e Kontratës dhe ndonjë kosto tjetër apo shpenzim që shkaktohet nga Banka në apo në lidhje me ndërtimin e Asetit plus një normë qarkulluese e shënjimit për 6 muaj EURIBOR plus 155 pikë bazë në vit që aplikohet në secilin Disbursim gjatë Periudhës së Zhvillimit
Marrëveshja e Konsulencës:	Marrëveshja me Konsulentin për ofrimin e shërbimeve të konsulencës që i përkasin Asetit.
Konsulenti:	Konsulenti të cilit do t'i besohet mbikëqyrja e Asetit që do të ndërtohet sipas Kontratës ashtu siç është treguar në Marrëveshjen e Konsulencës.
Kontrata:	Kontrata për ndërtimin e Asetit e lidhur në emër të Bankës nga Pranuesi, përmes Agjencionit Ekzekutues, me Kontraktuesin.
Çmimi i kontratës:	Shuma e pagueshme për Kontraktuesin për ndërtimin e Asetit.
Kontraktuesi:	Kontraktuesi të cilit do t'i besohet ndërtimi i Asetit.
Disbursimi:	Pagesa aktuale e ndonjë pjese të Shumës së Aprovuar.
Data efektive:	Data kur Banka e deklaron këtë Marrëveshje efektive në përputhje me Nenin - 8
EURIBOR:	Në lidhje me një pikë të veçantë, vlera aritmetike (e rrumbullakuar nëse është e nevojshme në pesë vende decimale) të normave të ofruara të ndër bankës për depozitat e Euros për aso periudhe në apo rreth orës 11.00 para dite. (koha në Bruksel) ashtu siç jepet në faqen 01 të EURIBOR të Shërbimit Reuter për Monitorimin e Normave të të Hollave (apo një faqe e tillë tjetër e cila mund të zëvendësoj atë faqe të EURIBOR për asi shërbimi për qëllime të shfaqjes së normave të ofruara të ndër bankës të Bankave kryesore të njohura si Banka Referuese për Depozitat në Euro).
Euro dhe “€”:	Valuta ligjore e shumicës së Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian.
Ngjarja e dështimit	Ndodhia e secilës ngjarje e përcaktuar në nenin -6.
Agjencioni Ekzekutues:	Ministria e Infrastrukturës.
Disbursimi i parë:	Pagesa e parë pas efikasitetit të kësaj Marrëveshjeje në përputhje me politikat dhe udhëzimet përkatëse të Bankës.
Marrëveshja Kornizë:	Marrëveshja kornizë e asaj date në mes të Republikës së

Kosovës dhe Bankës Islamike për Zhvillim për statusin dhe bashkëpunimin në lidhje me veprimet e Bankës në Republikën e Kosovës.

Periudha e zhvillimit:

Periudha që fillon në datën e Disbursimit të parë dhe që përfundon tre (3) vite pas kësaj.

Istisna'a:

Istisna'a është një mënyrë Islamike e financimit. Kjo bazohet në kontratën për prodhim (apo ndërtim) në mes të prodhuesit (shitësit) dhe pranuesit (blerësit) me të cilën shitësi pajtohet t'i ofroj blerësit mallrat (apo asetet) që identifikohen me përshkrim pasi që ato të jenë prodhuar/ndërtuar në përputhje me përshkrimin në një çmim të përcaktuar dhe në datën fikse të dorëzimit. Sipas kësaj mënyre të financimit, Banka zakonisht i financon punët civile/ndërtimin. Marrëveshja e Istisna'a në mes të Bankës dhe Pranuesit i cakton kushtet e përgjithshme të pagesës.

Projekti:

Ka kuptimin i cili i është dhënë atij në Përshkrimin A më lartë.

**Praktikat
sankionueshme:**

- e Secila nga praktika e korruptuar, praktika detyruese, praktika e fshehtë, praktika mashtruese apo praktika obstruktive ashtu siç definohet më poshtë:
 - (a) **Praktikë e korruptuar:** nënkupton ofrimin, dhënie, pranimin, apo detyrimin direkt apo indirekt, çfarëdo qoftë me vlerë që në mënyrë të pahijshme të ndikojë veprimet e Palës tjetër;
 - (b) **Praktikë detyruese:** nënkupton secilin veprim apo mosveprim që pengon a dëmton, apo kërcënon të pengoj a të dëmtoj, direkt a indirekt, çfarëdo Pale apo pronën e palës që të ndikoj në mënyrë të pahijshme në veprimet e Palës.
 - (c) **Praktikë e fshehtë:** nënkupton një aranzhim në mes të dy a më shumë palëve të dizajnuara për të arritur një qëllim të pahijshëm, duke përfshirë ndikimin e pahijshëm në veprimet e Palës tjetër.
 - (d) **Praktikë mashtruese:** nënkupton një veprim a mosveprim, duke përfshirë keq përfaqësimin, që me dashje a nga pakujdesia lajthit, apo përpiqet të lajthit, Palën për të fituar përfitim financiar apo tjetër apo për t'iu shmangur obligimit.
 - (e) **Praktikë obstruktive:** nënkupton ,
 - (i) Qëllimisht shkatërron, falsifikon, ndryshon apo fsheh materialin e dëshmisë për hetim apo bërjen e dëshmive falsë para hetuesve, në mënyrë që të pengoj materialisht hetimin e Bankës në pohimet e praktikës së korruptuar, mashtruese, detyruese apo të fshehtë, dhe/apo

kërcënon, shqetëson apo shantazhin ndonjë palë për të parandaluar atë nga shpalosja e çështjeve të njohura që janë relevante për hetim apo për ndjekjen e hetimit, apo

- (ii) Veprimet që kanë për qëllim që materialisht të pengojnë ushtrimin e qasjes së Bankës në informatat e kërkuara me kontratë në lidhje me hetimin e Bankës në pohimet e praktikës së korruptuar, mashtruese, detyruese apo të fshehtë.

Çmimi i Shitjes:

Çmimi i Asetit që i paguhet Bankës nga Pranuesi në përputhje me nenin – 3.

Norma e këmbimit të Euros:

Norma e cituar në ekranet e Reuter EURSFIX= një ditë pune para datës së Disbursimit të parë.

Tatimi:

Çfarëdo tatimi, ngarkese tatimore, taksë, taksë doganore apo ndonjë ngarkesë me natyrë të njëjtë (duke përfshirë pa kufizim secilin ndëshkim që është i pagueshëm në lidhje me ndonjë dështim për ta paguar apo vonesë në pagesën e ndonjë pagesë të ngjashme).

1.1 Interpretimi:

- (i) “aneksi”, “skeda”, duke iu nënshtruar ndonjë indikacioni të kundërt, do të interpretohet si referencë në aneks, skedë të Marrëveshjes apo dokument ku një referencë e tillë shfaqet;
- (ii) “përfshirë” do të interpretohet si referencë në “përfshirë, pa kufizim”;
- (iii) Kjo Marrëveshje apo ndonjë marrëveshje a dokument tjetër do të interpretohet si referencë në këtë Marrëveshje apo, siç mund të jetë rasti, një marrëveshje apo dokument tjetër i tillë ngase i njëjti mund të ketë qenë, apo që herë pas here, mund të amendamentohet, të ndryshohet, të shënohet apo të plotësohet;
- (iv) “Neni”, “seksioni”, “paragrafi, or “preambula”, përveçqë nëse shfaqet një indikacion i kundërt, do të interpretohet si një në këtë apo ndaj kësaj Marrëveshjeje;
- (v) Titujt në këtë Marrëveshje janë vetëm për përshtatshmëri dhe nuk mëtojnë, dhe nuk do të interpretohen, për të ndryshuar, kufizuar, apo rritur fushëveprimin apo kuptimin e gjuhës që e përmban kjo Marrëveshje;
- (vi) Njëjësi e përshin shumësin dhe anasjelltas;
- (vii) “dita” dhe “viti” do të jenë dita, muaji, viti, përkatësisht kalendari Gregorian; dhe
- (viii) Fjalët dhe shprehjet e përcaktuara në Marrëveshjen e Agjencionit dhe të cilat nuk janë përcaktuar këtu do të kenë të njëjtin kuptim si ai i dhënë në Marrëveshjen e Agjencionit.

Neni-2 NDËRTIMI DHE PRANIMI I ASETIT

- 2.1 Banka pajtohet që Aseti të ndërtohet në përputhje me kushtet e përgjithshme të kësaj Marrëveshjeje dhe Pranuesi pajtohet që të marrë përsipër Asetin sipas kushteve të përgjithshme të përcaktuara në këtë Marrëveshje dhe për të paguar Çmimin e Shitjes.
- 2.2 Për t'iu shmangur ndonjë dyshimi, Pranuesi pajtohet që Kontraktuesi do të ndërtoj Asetin për Bankën i cili do të përzgjidhet në përputhje me dispozitat përkatëse të dhëna në Marrëveshjen e Agjencionit.
- 2.3 Duke iu nënshtruar neneve 2.5, 2.6, 2.7, 2.8 dhe 7, ndërtimi i Asetit dio të përfundoj brenda 3 (tre) viteve nga data e Disbursimit të Parë.
- 2.4 Pranuesi do t'iu ofroj secilën mundësi të arsyeshme përfaqësuese të akredituar të Bankës që të bëjnë vizita për qëllimet që kanë të bëjnë me Asetin, dhe do të inspektojnë Projektin, Asetin dhe ndonjë regjistër a dokument përkatës dhe do t'iu ofroj Bankës të gjitha informatat e tilla siç mund t'iu kërkoj Banka në mënyrë të arsyeshme në lidhje me shpenzimet e Shumës së Aprovuar, Projektit, Asetit, dhe veprimeve e pozitës financiare të Pranuesit gjatë implementimit të Projektit dhe gjersa të gjitha pagesat këtu të jenë bërë nga Pranuesi plotësisht.
- 2.5 Pranuesi do të udhëzoj Agjencionin Ekzekutues që në mënyrë të parevokueshme të pranoj Asetin për të gjitha qëllimet nga kjo kur Agjencioni Ekzekutues e nënshkruan Certifikatën Përfundimtare të Pranimit.
- 2.6 **Kushti i Asetit:** Pa paragjykuar të mëparshmen, Banka nuk do të ketë kurrfarë përgjegjësie a detyrimi çfarëdo qoftë ai ndaj Pranuesit apo ndaj ndonjë personi tjetër apo entiteti, sa i përket:
- (a) Ndonjë detyrimi, humbjeje apo dëmtimi i shkaktuar (apo që pohohet të jetë shkaktuar) direkt apo indirekt nga Aseti apo nga ndonjë papërshtatshmëri nga kjo apo mangësi a defekt aty apo nga ndonjë rrethanë tjetër në lidhje me këtë;
 - (b) Në lidhje me përdorimin apo operimin e Asetit apo ndonjë rreziku që lidhet me të;
 - (c) Ndonjë ndërprerjeje të shërbimit, humbjes së punës apo përfitimit të parashikuar apo dëmeve të mëpasshme.
- 2.7 Banka ndërmerr që t'ia caktoj Pranuesit përfitimin e secilit garantues, kusht apo garanci që ka të bëjë me Asetin e cila mund t'iu jetë dhënë Bankës nga Kontraktuesi dhe e cila është ekzaminuar dhe pranuar nga Pranuesi dhe të gjitha kushtet e garancitë tjera të cila mund të nënkuptohen me ligj apo të pranuar nga zakoni në favor të Bankës. Përveç kësaj, Banka do të ndërmerr atë veprim tjetër të tillë siç mund ta kërkoj Pranuesi në mënyrë të arsyeshme për t'iu mundësuar Pranuesit që të kërkoj kundrejt Kontaktuesit.
- 2.8 **Pronësia dhe rreziku:** Titulli ndaj dhe rreziku në Aset do t'iu kaloj Pranuesit me të nënshkruar Certifikatën Përfundimtare të Pranimit.

Neni -3 PAGESA E ÇMIMIT TË SHITJES

- 3.1 Çmimi i Shitjes është EUR19,844,235.28 (nëntëmbëdhjetë milion e tetëqind e dyzet e katër mijë e dyqind e tridhjetë e pesë e njëzet e tetë Euro cent)
- 3.2 Çmimi i Shitjes do të ri-kalkulohet në fund të Periudhës së Zhvillimit bazuar në koston kapitale plus një normë qarkulluese e shënjimit për 6 muaj EURIBOR ku Norma e Këmbimit mbizotëron në kohën që korrespondon me periudhën e amortizimit të kapitalit plus 155 pikë bazë në vit.
- 3.3 Kostoja kapitale do të përcaktohet bazuar në Disbursimet totale në fund të Periudhës së Zhvillimit, apo në kohën e shitjes, plus një normë qarkulluese e shënjimit për 6 muaj EURIBOR plus 155 pikë bazë në vit që aplikohet në secilin Disbursim.
- 3.4 Pranuesi do të paguaj Çmimin e Shitjes për 30 (tridhjetë) këste të barabarta dhe të vazhdueshme gjashtë mujore, i pari nga të cilët do të jetë për t'u paguar dhe i pagueshëm 6 (gjashtë) muaj nga Fundi i Periudhës së Zhvillimit. Banka do të dërgoj Skedën e Pagesës së Çmimit të Shitjes menjëherë pas lëshimit të Certifikatës Përfundimtare të Pranimit.
- 3.5 Duke iu nënshtruar nenit 3.6 dhe 3.7, secila pagesë që do të bëhet nga Pranuesi për Bankë këtu do të bëhet në secilën valutë të konvertueshme që është e pranueshme për Bankën për vlerësim në datën për pagesë në llogarinë e bankës apo në një mënyrë të tillë tjetër siç mund ta njoftoj Banka herë pas here Pranuesin me shkrim.
- 3.6 Secila pagesë që do të bëhet këtu do të konsiderohet se është paguar siç duhet kur cilado nga bankat ia konfirmon Bankës pranimin e pagesës së tillë në llogarinë bankare me të:
- | <u>Në Dollar amerikan:</u> | <u>Në sterlinë:</u> | <u>Në EURO:</u> |
|--|--|--|
| A/c No: | A/c No: | A/c No: |
| GB36SINT60928000159111 | GB13SINT60928000159137 | FR7643899000019696500151088 |
| Gulf International Bank (UK)
Ltd, One Knightsbridge
London SW1X 7XS
United Kingdom
Telex No. 8812261/2
Swift Code: SINTGB2L | Gulf International Bank (UK)
Ltd, One Knightsbridge
London SW1X 7XS
United Kingdom
Telex No. 8812261/2
Swift Code: SINTGB2L | Union De Banques Arabes Et
Françaises (UBAF)
92523 Paris, Neuilly Cedex
France
Télex No. 610334 UBAF
Swift Code: UBAFRPPXXX |
- 3.7 Nëse ndonjë pagesë i skadon afati në ditën e cila nuk është Ditë Pune, pagesa do të bëhet në ditën vijuese të Ditës së Punës.
- 3.8 Të gjitha pagesat e bëra nga Pranuesi do të bëhen të lira e pa zbritur, në lidhje me, ndonjë tatim, hipotekë, kundërkërkesë apo ndonjë gjë tjetër. Nëse nga Pranuesi kërkohet me ligj për të bërë ndonjë zbritje apo për të ndalur ndonjë shumë të pagueshme nga ai këtu, shuma e pagueshme nga ai në lidhje me të cilën një zbritje apo ndalim kërkohet për t'u bërë do të ngritet deri në atë masë që është e nevojshme për të siguruar se, pas bërjes së zbritjes së tillë apo ndalimit, Banka pranon dhe e mban (pa detyrim në lidhje me ndonjë zbritje a ndalim të tillë) një shumë neto të cilën do të kishte pranuar dhe në këtë mënyrë të kishte mbajtur nëse një zbritje apo ndalim i tillë të mos ishte bërë.
- 3.9 Nëse Pranuesi dështon që të paguaj ndonjë shumë të pagueshme këtu kur e ajo e ka afatin, Pranuesi do të,

- (i) Në përputhje me Parimet e Sheriatit Islamik, do të kompensoj Bankën për ndonjë humbje, dëmtim, kostot e arsyeshme aktuale dhe shpenzimet (duke përfshirë por duke mos u kufizuar në kostot dhe shpenzimet ligjore, apo ato të mbledhura të agjentit) të shkaktuara nga Banka si rezultat i vonesës në pagesën e Bankës.
- (ii) Do t'i paguaj Bankës një ngarkesë të vonuar të pagesës në lidhje me shumën e tejkualuar në afat, secila ngarkesë e tillë e vonuar për pagesë do të kalkulohet dhe aplikohet si shumë e përcaktuar nga Banka pas aplikimit të formulës që jepet më poshtë:

$$\frac{A \times B \times C}{360} \quad \text{Ku:} \quad \begin{array}{l} \text{"A"} \text{ nënkupton shumën e papaguar;} \\ \text{"B"} \text{ nënkupton } \mathbf{01\%} \text{ në vit; dhe} \\ \text{"C"} \text{ nënkupton numrin e ditëve nga dhe duke përfshirë} \\ \text{atë datë me afat, dhe duke përfshirë datën e pagesës} \\ \text{aktuale (qoftë para apo pas vendimit).} \end{array}$$

Banka, pas zbritjes së të gjitha kostove dhe shpenzimeve aktuale të shkaktuara, do të paguaj secilën shumë të pranuar sipas këtij Neni në Llogarinë e Bankare të Fondeve Waqf.

Nr i llogarisë: 0000 100 102
Emri i Bankës: The British Arab Commercial Bank
SWIFT Code: BACMGB2L
IBAN: GB69 BACM 4051 3200 100 102

Neni -4 PEZULLIMI, ANULIMI DHE NDËRPRERJA

- 4.1 Nëse Kontrata nuk nënshkruhet brenda 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditëve nga Data Efektive e kësaj Marrëveshjeje, apo Pranuesi nuk ka kërkuar për Disbursimin e Parë, Banka, duke njoftuar Pranuesin, mund të anuloj Shumën e Aprovuar, përveç nëse është e kënaqur me arsyetimin e Pranuesit për një vonesë të tillë.
- 4.2 Pranuesi mund të kërkojë nga Banka të ndërpres këtë Marrëveshje dhe të anuloj Shumën e Aprovuar në çfarëdo kohe para nënshkrimit të kësaj kontrate.
- 4.3 Nëse në çfarëdo kohe Banka vendos, pas konsultimit me Pranuesin, se ndonjë pjesë e Shumës së Aprovuar nuk do të kërkohet për të financuar Projektin, Banka mund t'i jap njoftim Pranuesit duke ndërprerë këtë ndërmarrje nga Banka për disbursimin e një pjese të tillë. Ajo pjesë e Shumës së Aprovuar do të konsiderohet e anuluar me të marrë një njoftim të tillë.
- 4.4 Pasi Bankës t'i paguhen të gjitha shumat që kanë afatin për pagesë sipas kësaj Marrëveshjeje, kjo Marrëveshje do të ndërpritet dhe obligimet e Palëve këtu do të ushtrohen.
- 4.5 Banka, duke i dhënë njoftim Pranuesit, mund të pezulloj a ndërpres këtë Marrëveshje dhe të pezulloj a anuloj Shumën e Aprovuar apo ndonjë pjesë nga kjo në secilin nga rastet si në vijim:
- (a) Një situatë e jashtëzakonshme do të ketë ndodhur e cila,

- (i) Do ta bëj atë, sipas mendimit të Bankës, të pamundshme që Pranuesi do të jetë në gjendje për t'i përmbushur obligimet sipas kësaj Marrëveshjeje, apo
- (ii) Do të parandaloj arritjen e qëllimeve për të cilat kjo Marrëveshje është lidhur.

Nëse ndonjë pjesë e tokës së kërkuar nuk është blerë më kohë sipas “Vendimit Përfundimtar” për implementimin e fazës përkatëse të projektit, ngjarja e tillë do të konsiderohet si një situatë e jashtëzakonshme për qëllime të këtij Neni.

- (b) Një përfaqësim që bëhet nga Pranuesi apo ndonjë deklaratë e dorëzuar apo që mëtohet të ketë mbështetje nga Banka në procedimin e Projektit për aprovim apo për lidhjen e kësaj Marrëveshjeje, do të ketë qenë jo e kompletuar apo e pasaktë në secilin pikëpamje materiale;
- (c) Banka përcakton se –
 - (i) Pranuesi është në shkelje të obligimeve të tij sipas kësaj Marrëveshjeje, apo
 - (ii) Në lidhje me ekzekutimin të ndonjë Kontrate që do të financohet plotësisht apo pjesërisht nga shumët e financimit, nëse ndonjë person apo entitet është angazhuar në ndonjë Praktikë të Sanksionueshme para se Pranuesi të ketë ndërmarr ndonjë veprim me kohë apo të përshtatshëm që është i kënaqshëm për Bankën për të korrigjuar situatën apo për të adresuar praktikatat e tilla kur ato të ndodhin.
- (d) Pranuesi ka dështuar në ushtrimin e obligimeve të tij për të paguar ndonjë shumë që është për t'u paguar Bankës (apo ndonjë dege të Bankës).

4.6 Secili pezullim i Marrëveshjes apo i Shumës së Aprovuar do të vazhdoj gjersa ngjarja apo ngjarjet të cilat shkaktuan një pezullim të tillë do të kenë pushuar së ekzistuari apo gjersa Banka do të ketë njoftuar Pranuesin se ndërmarrja e Bankës për të prokuruar Asetin është rivendosur, cilado qoftë të jetë më herët; megjithatë, me kusht që në rast të ndonjë njoftimi të tillë të rivendosur, ndërmarrja për të ndërtuar Asetin do të rivendoset vetëm deri në atë masë dhe duke iu nënshtruar kushteve të saktësuara në një njoftim të tillë, dhe asnjë njoftim i tillë nuk do të ndikoj apo pengoj ndonjë të drejtë, kompetencë a korrigjim të Bankës në lidhje me ndonjë ngjarje tjetër apo të më pastajme që është përshkruar në këtë Nen.

4.7 Në rast se Kontraktuesi dështon t'i përmbush ndonjë nga obligimet e veta sipas Kontratës dhe Pranuesi, në konsultim me Bankën, e ndërprentë Kontratën në përputhje me kushtet e saja, ndërprerja e tillë, pas 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga ndërprerja e tillë, do të veproj si anulim i ndonjë shume që ka mbetur e padisbursuar nga Shuma e Aprovuar, përveç nëse Banka pajtohet ndryshe. Pavarësisht nga ndërprerja e kësaj Marrëveshjeje, Pranuesi do të vazhdoj të bashkë veproj me dhe të asistoj Bankën për të kthyer nga Kontraktuesi një pjesë të tillë Çmimit të Kontratës dhe ndonjë shumë tjetër që mund të jetë disbursuar nga Banka para ndërprerjes së Kontratës.

4.8 Anulimi i Shumës së Aprovuar apo ndonjë pjesë nga kjo nuk do të ndikoj ndonjë zotim të bërë, obligime të shkaktuara apo të drejtat e shtuara para datës së anulimit.

- 4.9 Përveç nëse Disbursimi është bërë nga Shuma e Aprovuar, nëse Shuma e Aprovuar anulohet, Marrëveshja do të konsiderohet automatikisht e ndërprerë.
- 4.10 Pjesa e pa disbursuar e Shumës së Aprovuar automatikisht do të anulohet në rast të ndërprerjes së kësaj Marrëveshjeje apo Marrëveshjes së Agjencionit.
- 4.11 Pas anulimit të Shumës së Aprovuar apo ndonjë pjese nga kjo dhe/apo ndërprerjes së kësaj Marrëveshjeje për shkak të Ngjarjes së Dështimit, apo shkeljes nga Pranuesi të obligimeve të tij sipas kësaj Marrëveshjeje dhe/apo dështimit për të siguruar ofrimin e Asetit, Pranuesi do të shpërblej Bankën me një shumë të barabartë me Koston kapitale dhe me zotimin e vendosur apo të shkaktuar, që nga data e ndërprerjes.

Neni -5 PËRFAQËSIMET

Pranuesi përfaqëson se:

- (i) Të gjitha autorizimet qeveritare dhe veprimet e çfarëdo lloji të nevojshme për autorizim apo që kërkohen për vlefshmërinë apo zbatueshmërinë e obligimeve të parashikuara sipas kësaj Marrëveshjeje kundër Pranuesit janë marrë apo janë kryer dhe janë valide dhe vlejné e janë në fuqi dhe efekt të plotë.
- (ii) Sipas ligjeve në fuqi të Republikës së Kosovës në datën e kësaj Marrëveshjeje, pohimet e Bankës kundër Pranuesit sipas kësaj Marrëveshjeje do të radhiten së paku *pari passu* me pohimet e të gjithë kreditorëve tjerë të pasigurt për ndonjë borxh të Pranuesit; dhe
- (iii) Autoriteti në fjalë, aktualisht Njësia e Borxhit në kuadër të Thesarit në Ministrinë e Financave e ngarkuar me shërbimin e borxhit të jashtëm është udhëzuar për të bërë pagesën e kësteve të Çmimit të Ulur në datat për pagesë.

Neni -6 NGJARJET E DËSHTIMIT

- 6.1 Nëse njëra nga ngjarjet e saktësuara në këtë nen do të ketë ndodhur dhe vazhdon të ndodh atëherë Banka, duke i dhënë njoftim Pranuesit, mund të deklaroj tërë apo një pjesë të Çmimit të Shitjes që është, dhe e njëjta me anë të kësaj do të bëhet, menjëherë për pagesë dhe e pagueshme (çdo gjë në këtë Marrëveshje pavarësisht) pa ndonjë njoftim tjetër:
- (a) Dështimi do të ketë ndodhur në pagesën e ndjenë kësti të Çmimit të Shitjes dhe dështimi i tillë do të ketë vazhduar për një periudhë prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve.
 - (b) Dështimi, përveç dështimit të saktësuar në Nenin 6.1 (a), do të ketë ndodhur në performancën e ndonjë obligimi të Pranuesit sipas kësaj Marrëveshjeje dhe secila nga këto dështime do të ketë vazhduar për një periudhë prej 30 (tridhjetë) ditëve.
 - (c) Çfarëdo përfaqësimi apo garantimi i konfirmuar apo i bërë nga Pranuesi në lidhje me ekzekutimin dhe ofrimin e kësaj Marrëveshjeje, apo në lidhje me ndonjë kërkesë për disbursim sipas kësaj Marrëveshjeje, do të konstatohet se është jo korrekte në secilin pikëpamje materiale dhe do të vazhdoj të jetë jo

korrekte për një periudhe prej 30 (tridhjetë) ditëve pas njoftimit që nga kjo t'i jetë dhënë Pranuesit nga Banka;

- (d) Pranuesi nuk do të jetë në gjendje për të paguar borxhet e tij pasi që atyre u skadon afati apo ndryshe borxhet janë bërë të paafta për pagesë; apo ndonjë mbajtës i garancisë ligjërisht të ketë marrë posedimin apo pranuesi apo administruesi i besuar të jetë caktuar për tërë apo për një pjesë të ndërmarrjes apo asetëve të Pranuesit; apo garanci apo ekzekutim (apo proceseve të ngjashme) do të vihet tatim apo do të zbatohen pas a do të lëshohen kundrejt ndonjë pasurie të paluajtshme apo pasurie të Pranuesit dhe se garancia apo ekzekutimi i tillë nuk do të ushtrohen brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve; apo të jetë bërë një urdhër apo një rezolutë efektive të jetë kaluar apo procedurat e ngjashme merren për likuidimin e Pranuesit, falimentimin apo shpërbërjen; apo ndonjë ngjarje tjetër do të ketë ndodhur e cila sipas ndonjë ligji të aplikueshëm do të kishte një efekt të ngjashëm me ndonjë nga ato ngjarjet e dhëna në listë në këtë paragraf;
 - (e) Ndonjë dispozitë e kësaj marrëveshjeje është apo bëhet jo valide, e paligjshme apo e pa zbatueshme;
- 6.2 Nëse do të ketë ndodhur ndonjë Ngjarje e dështimit apo ndonjë ngjarje e cila me kalimin e kohës apo njoftimit dhe me kalimin e kohës do të bëhet një Ngjarje e Dështimit, Pranuesi menjëherë do t'i jepte Bankës një njoftim me faksimil apo teleks, me anë të kësaj duke saktësuar natyrën e një Ngjarjeje të tillë të dështimit apo ngjarja e tillë dhe ndonjë hap që Pranuesi po i ndërmerr për të korrigjuar të njëjtën.
- 6.3 Asnjë veprim i ndërmarrjes dhe asnjë vonesë në ushtrimin, apo dështimin për të ushtruar, ndonjë të drejtë, kompetencë apo korrigjim që i shkaktohet Bankës pas ndonjë dështimi sipas kësaj Marrëveshjeje apo ndonjë marrëveshjeje të tillë, nuk do të pengoj ndonjë të drejtë, kompetencë apo korrigjim apo nuk do të interpretohet se heq dorë nga kjo apo pranim i heshtur në të; e as veprimi i Bankës në lidhje me ndonjë dështim të tillë, apo ndonjë pranim të heshtur nga ajo aty nuk do të ndikoj apo pengoj ndonjë të drejtë, kompetencë apo korrigjim të Bankës në lidhje me ndonjë dështim tjetër.

Neni -7 DËMSHPËRBLIMI

- 7.1 Pranuesi me këtë ndërmerr të dëmshpërblej Bankën, në bazë neto pas heqjes së taksave (në normën tatimore të aplikueshme lokale dhe të huaj) kundrejt, dhe pajtohet të mbroj, ruaj dhe të mbaj të padëmshme Bankën nga ndonjë obligim apo nga të gjitha obligimet, tarifat, detyrimet, humbjet, dëmshpërblimet, ndëshkimet, kërkesat, veprimet, vendimet dhe shpenzimet duke i përfshirë tarifat dhe shpenzimet e arsyeshme ligjore (duke i përfshirë tarifat dhe shpenzimet e tilla ligjore që janë shkaktuar në lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje), të secilit lloj dhe natyrë çfarëdo qoftë ajo e imponuar, e shkaktuar, apo e pohuar kundrejt Bankës që del nga:
- (a) Pronësia, posedimi, shfrytëzimi, dokumentimi, largimi, kthimi apo aplikimet tjera apo dispozitat sipas Kontratës apo Marrëveshjes së Konsulencës, duke i përfshirë të tillat siç mund të dalin nga:
 - (i) Ndonjë humbje apo dëmtim të ndonjë pasurie apo vdekje e lëndim ndaj ndonjë personi;

- (ii) Defektet e dukshme apo të fshehura në Aset:
 - (iii) Ndonjë kërkesë sipas detyrimit rigoroz si veprim i dëmshëm apo ndryshe;
 - (iv) Çfarëdo kërkesë bazuar në shkeljen e patentës, markës dhe të drejtës së autorit;
 - (v) Ndonjë kërkesë bazuar në detyrimin që del sipas ligjeve të aplikueshme mjedisore apo aprovimeve mjedisore;
 - (vi) Ndonjë kërkesë në lidhje me titullin e Asetit apo tokën në të cilën kjo ndërtohet;
 - (vii) Ndonjë kërkesë apo kontest në lidhje me kontratën apo ndonjë Letër Kredie që është vendosur sipas asaj apo në lidhje me Marrëveshjen e Konsulencës.
- (b) Ndodhia e ndonjë dështimi apo ndonjë dështim tjetër në lidhje me Pranuesin apo Kontraktuesin për të performuar apo për të respektuar ndonjë kusht të kësaj Marrëveshjeje, apo ndonjë dokument, marrëveshje apo kontratë e lidhur në lidhje me këtë në apo ndryshe në lidhje me Asetin, por duke përjashtuar ndonjë kërkesë bazuar në ndonjë dështim në lidhje me Bankën për t'i respektuar obligimet e saj sipas kësaj Marrëveshjeje apo ndonjë dokument, marrëveshje apo kontratë e lidhur nga Banka në lidhje me këtë apo ndryshe në lidhje me Asetin;
- (c) Ndonjë kërkesë, person në ngarkim, interesat e sigurisë dhe pengimet apo proceset ligjore në lidhje me titullin për apo interesin në Aset apo në tokën ku kjo ndërtohet.

7.2 Pranuesi do t'i jap Bankës një njoftim të menjëhershëm për ndonjë ndodhi apo kusht të njohur për Pranuesin si pasojë e së cilës Banka është apo ka të ngjarë arsyeshëm të ketë të drejtën për dëmshpërblym. Dëmshpërblymi i dhënë në Nenin – 7.1 në veçanti do të aplikohet dhe do të përfshij kërkesat apo veprimet të shkaktuara nga apo në emër të punonjësve të Pranuesit dhe me këtë Pranuesi në mënyrë të qartë heq dorë, sikur kundër Bankës, çfarëdo imuniteti për të cilin Pranuesi ndryshe mund të ketë të drejtë sipas ndonjë ligji të aplikueshëm. Pranuesi menjëherë pas kërkesës nga Banka (por në secilin rast brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve të kërkesës së tillë) do të rimburoj Bankën për shumat e shpenzuara nga ajo në lidhje me ndonjë të përmendur apo do të paguaj shumën e tillë direkt. Pranuesi do të zëvendësohet për të drejtat e Bankës në ndonjë mënyrë në lidhje me të cilën Pranuesi në fakt ka rimbursuar Bankën për shumat e shpenzuara nga ajo apo në fakt i ka paguar shumat e tilla direkt sipas Nenit - 7.1. Në rast se ndonjë veprim apo procedurë vihet para bankës në lidhje me kërkesën e dëmshpërblyer, Banka, pas pranimi të njoftimit për fillimin e një veprimi apo procedure të tillë, do të njoftoj Pranuesin me anë të kësaj, duke bashkëmbyllur një kopje të letrave që i janë shërbyer Bankës. Pranuesi mund, dhe me kërkesë të Bankës, do të rezistoj dhe mbroj një veprim të tillë apo procedurë me shpenzimet e pranuesit, apo do të shkaktoj të njëjtin të rezistoj apo të mbrohet përmes avokatit të zgjedhur nga Pranuesi që është arsyeshëm i kënaqshëm për Bankën. Në rast të ndonjë dështimi nga pranuesi për të vepruar ashtu, Pranuesi do t'i paguaj të gjitha kostot dhe shpenzimet (duke përfshirë tarifat dhe shpenzimet e arsyeshme të avokatit) të shkaktuara nga Banka në lidhje me një veprim apo procedurë të tillë.

Neni -8 EFEKTIVITETI

- 8.1 Kjo Marrëveshje nuk dot jetë efektive përveç nëse dhe përderisa Pranuesi e furnizon Bankën me dokumentet si në vijim:
- (i) Dëshminë e kënaqshme për Bankën deri në atë shkallë sa Marrëveshja Kornizë e saja date është nënshkruar dhe ratifikuar si duhet nga autoritetet kompetente në Republikën e Kosovës.
 - (ii) Dëshminë e kënaqshme për Bankën deri në atë shkallë sa ekzekutimi dhe dorëzimi i kësaj Marrëveshjeje në emër të Pranuesit është autorizuar dhe ratifikuar si duhet nga Kuvendi apo Parlamenti i Republikës së Kosovës;
 - (iii) Opinioni ligjor i pranueshëm për Bankën që buron nga **autoriteti kryesor ligjor dhe/apo gjyqësor** i Pranuesit duke theksuar se kushtet e përgjithshme të kësaj Marrëveshjeje dhe të Kornizës përbëjnë obligime të zbatueshme detyruese për Pranuesin në thelb në formën e ofruar në Aneksin – III të kësaj Marrëveshjeje;
 - (iv) Pranuesi, përmes Ministrisë së Financave, do t'i ofroj bankës një letër duke konfirmuar se Thesari në kuadër të Ministrisë së Financave i ngarkuar me shërbimin e borxhit të jashtëm është udhëzuar për të bërë një pagesë të kësteve të Çmimit të Shitjes në datat e afatit;
 - (v) Dëshmia e kënaqshme për Bankën se “Vendimi Përfundimtar” i Qeverisë së Kosovës në lidhje me eksproprijimin e tokës që kërkohet për Projektin është publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës;
 - (vi) Dëshmia e kënaqshme për Bankën deri na atë shkallë sa të gjitha kushtet paraprake për të drejtat e Pranuesit për të marrë fonde nga bashkë financuesit tjerë, janë përmbushur, dhe se bashkë financimi është në dispozicion; dhe
 - (vii) Dëshmia e kënaqshme për Bankën deri në atë shkallë sa Pranuesi ka alokuar buxhetin nevojshëm për të kontribuar në projekt.
- 8.2 Nëse Marrëveshja nuk ka hyrë në fuqi brenda 6 (gjashtë) muajve nga data e nënshkrimit, Marrëveshja dhe të gjitha obligimet e Palëve këtu do të ndërpriten, përveç nëse Banka, pas marrjes parasysh se arsyeve për vonesë, do të vendos një datë të mëvonshme për qëllimet e këtij neni. Banka do të informoj menjëherë Pranuesin për datën e tillë të mëvonshme apo për ndërprerjen e marrëveshjes, siç mund të jetë rasti.

Neni -9 HEQJE DORË

Dështimi i Bankës për të ushtruar apo mbrojtur ndonjë nga të drejtat e saj sipas kësaj Marrëveshjeje apo vonesa e saj në të njëjtën apo dështimi i saj për të ushtruar a mbrojtur ndonjë korrigjim që mund të ketë kundër Pranuesit apo vonesa e saj në të njëjtën, nuk do të paragjykoj të drejtën e tillë apo korrigjimin dhe nuk do të interpretohet si heqje dore nga një e drejtë e tillë apo korrigjim.

Neni -10 LIGJI MBIZOTËRUES – ZGJIDHA E MOSMARRËVESHJEVE

- 10.1 Kjo Marrëveshje do të drejtohet nga dhe do të interpretohet në përputhje me parimet e Sheriatit Islamik siç është shpallur nga Akademia Islamike Fiqh, e siç është shpallur

në Standardet e Sheriatit e publikuar nga Organizata e Kontabilitetit dhe Auditimit për Institucionet Financiare Islamike (AAOIFI), dhe ashtu siç interpretohet nga Komiteti i Sheriatit të Bankës.

- 10.2 Secila mosmarrëveshje në mes të Palëve në këtë Marrëveshje dhe secila kërkesë nga secila Palë kundër Palës tjetër që del nga kjo Marrëveshje, e cila nuk mund të përcaktohet me Marrëveshje të Palëve brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftimit të dorëzuar nga njëra Palë tek tjetra, do t'i dorëzohet panelit të Arbitrazhit për një vendim përfundimtar dhe detyruet në përputhje me rregullat dhe procedurat e Qendrës Ndërkombëtare Islamike për Pajtim dhe Arbitrazh (IICRA), Dubai, në Emiratet e Bashkuara Arabe. Rregullat dhe procedurat e arbitrazhit të IICRA do të jenë në vend të ndonjë procedure tjetër për përcaktimin e mosmarrëveshjeve në mes të Palëve në këtë Marrëveshje apo ndonjë kërkesë nga ndonjë Palë kundër Palës tjetër që del nga kjo.
- 10.3 Nëse brenda 30 (Tridhjetë) ditëve pasi që kopja ligjore e vendimit t'i jetë dorëzuar Palëve, vendimi nuk respektohet, secila Palë mund të hyj në vendim, apo të inicioj një procedurë gjyqësore për të zbatuar vendimin, në ndonjë gjykatë me juridiksion kompetent kundër Palës tjetër, mund të zbatoj një vendim të tillë me ekzekutim apo mund të ndjek ndonjë mjet tjetër të përshtatshëm ligjor kundër Palës tjetër për zbatimin e vendimit apo të dispozitave të kësaj Marrëveshjeje.
- 10.4 Secila palë në këtë Marrëveshje pajtohet se secili vendim që jepet sipas kësaj marrëveshjeje kundër saj mund të ekzekutohet kundrejt fondeve (aseteve) të saj në secilin juridiksion. Palët në këtë Marrëveshje me anë të kësaj në mënyrë të parevokueshme heqin dorë nga ndonjë kundërshtim që mund të kenë për ndonjë padi, veprim apo procedurë gjyqësore që dalin nga apo në lidhje me zbatimin e vendimit të arbitrazhit sipas kësaj Marrëveshjeje, nëse është sjellë në ndonjë juridiksion në të cilën ata i kanë fondet (asetet), dhe me këtë edhe më tutje në mënyrë të parevokueshme heqin dorë nga ndonjë kërkesë që ndonjë padi e tillë, veprim a procedurë gjyqësore e sjellë në ndonjë juridiksion është sjellë në ndonjë forum të papërshtatshëm.
- 10.5 Deri në atë masë sa Pala në këtë Marrëveshje mund në ndonjë juridiksion të kërkoj për vete apo për asetet e veta imunitet nga padia, ekzekutimi, bashkëngjitja (qoftë në ndihmë apo ekzekutim, para vendimit apo vendimit apo ndryshe) apo procesit tjetër ligjor apo deri në atë masë sa që në ndonjë juridiksion të tillë imuniteti i tillë mund t'i atribuohet vetës apo asetëve të saj (qoftë se a është kërkuar a jo), Pala e tillë në këtë në mënyrë të parevokueshme pajtohet që të mos kërkojë dhe në mënyrë të parevokueshme heq dorë nga imuniteti i tillë.

Neni -11 BASHKËRENDIMI DHE NJOFTIMET

- 11.1 **Bashkërendimi:** Pranuesi me këtë cakton Ministrin e Financave si përfaqësuesin e autorizuar të Pranuesit (**Përfaqësuesi i Pranuesit**) për të gjitha çështjet sipas kësaj Marrëveshjeje dhe për të gjitha intencat dhe qëllimet pa kufizim; në përputhje me rrethanat:

- (i) Që të merret me Bankën dhe të jetë direkt përgjegjës për përmbushjen e obligimeve në detyrë për Pranuesin me anë të kësaj Marrëveshjeje.
- (ii) Të gjitha komunikimet të secilit lloj që i jepen nga Banka Përfaqësuesit të Pranuesit do të konsiderohen se i janë dhënë siç duhet Pranuesit;
- (iii) Të gjitha komunikimet që pranohem nga Banka nga Përfaqësuesi i Pranuesit do të konsiderohen se janë dhënë apo janë bërë siç duhet, dhe janë pranuar nga, Pranuesi; dhe
- (iv) Përfaqësuesi i Pranuesit, gjatë gjithë kohës, do të zhvilloj një bashkërendim dhe bashkëpunim të duhur dhe efikas, dhe do të siguroj se Pranuesi dhe Agjencioni Ekzekutues i zbatojnë detyrat e tyre këtu.

11.2 **Njoftimet:** Secili njoftim, kërkesë, **aprovim, pëlqim** apo komunikim tjetër që do të jepet apo do të bëhet sipas kësaj Marrëveshjeje apo në lidhje me këtë do të jetë me shkrim dhe do të konsiderohet se janë dhënë siç duhet kur dorëzohen me dorë, postë ajrore, me shërbim ndërlidhës të vendosur, apo me faksimil Palës së cilës i jepet në adresën e Palës që është saktësuar më poshtë apo në ndonjë adresë tjetër të tillë të cilën Pala do t'ia ketë përcaktuar me njoftim Palës që e jep njoftimin, kërkesën apo komunikimin e tillë.

Për Pranuesin:

Ministria e Financave
Rr. Nëna Terezë, p.n. Prishtinë, 10000
Republika e Kosovës
Tel: +381 38 200 34 101
Fax: +381 38 213113
Email: zyraministrit@mfe-ks.org

Për Bankën:

P.O. Box 5925
Jeddah-21432
Mbretëria e Arabisë Saudite
Tel: +966 2 6361400
Fax: +966 2 6366871
Email: archives@isdb.org

Neni -12 TË NDRYSHME

- 12.1 Pjesa përshkruese dhe anekset janë pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje.
- 12.2 **Autoriteti:** Personi që e nënshkruan këtë Marrëveshje në emër të secilës Palë me këtë përfaqëson dhe i garanton palës tjetër se ai apo ajo e ka kompetencën e kërkuar ligjore dhe autoritetin për të ekzekutuar këtë Marrëveshje në emër të Palës dhe e detyron Palën ndaj obligimeve këtu.
- 12.3 **Kopjet ligjore:** Kjo Marrëveshje, duke i përfshirë amendamentimet, mund të ekzekutohet në kopjet ligjore të cilat kur merren së bashku do të përbëjnë një marrëveshje të vetme. Kopjet e kësaj Marrëveshjeje do të jenë barabartë të detyrueshme sa edhe origjinalet dhe nënshkrimet e kopjeve origjinale të dërguara me faks, apo të skanuara dhe të dërguara me email dhe do të jenë të mjaftueshme për të

dëshmuar ekzekutimin, ndonëse Palët mund të kërkojnë që t'u dorëzohen dokumentet e nënshkuara dhe origjinale.

12.4 **E tërë marrëveshja:** pa paragjykuar Nenin 12.5, kjo Marrëveshje është e tërë marrëveshja dhe e zëvendëson ndonjë marrëveshje tjetër paraprake me gojë a me shkrim apo komunikimet në mes të palëve në lidhje me temën në fjalë. Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje janë të ndara ashtu që nëse ndonjë dispozitë grindet se është jo valide, e paligjshme apo e pazbatueshme, një gjetje e tillë nuk do të ndikoj në vlefshmërinë, ndërtimin apo zbatueshmërinë e ndonjë dispozite të mbetur.

12.5 **Marrëveshja Kornizë:** pavarësisht çdo gjëje që përmbahet këtu në të kundërtën, kjo Marrëveshje dhe Marrëveshja e Agjencionit nënshkruhen në kuadër të frymës së Marrëveshjes Kornizë. Në rast të kundërshtimeve në mes të dispozitave të Marrëveshjes Kornizë dhe dispozitave të kësaj Marrëveshjeje dhe/apo Marrëveshjes së Agjencionit, dispozitat e Marrëveshjes Kornizë do të mbizotërojnë në lidhje me çështjen në fjalë të Marrëveshjes Kornizë.

12.6 **Amendamenti:** Kjo Marrëveshje mund të amendamentohet vetëm me një marrëveshje të dyanshme me shkrim të palëve.

12.7 **Data e Marrëveshjes:** data e kësaj Marrëveshjeje, për të gjitha qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, do të jetë ajo që shfaqet në preambulë.

[FUNDI I NENEVE]

Faqja e ekzekutimit:

Në cilësinë e dëshmitarit, Palët, përmes përfaqësuesve të tyre të autorizuar siç duhet, e kanë nënshkruar këtë Marrëveshje që ka të bëjë me financimin e Projektit në lidhje me përmirësimin e Rrugës Kryesore M2 Milloshevë–Mitrovicë me një shumë që nuk tejkalon €15,410.000.00 (Pesëmbëdhjetë Milion e Katërqind e Dhjetë Mijë Euro) përafërsisht që është ekuivalent me ID13,200,000.00 (Trembëdhjetë Milion e Dyqind Mijë Dinar Islamik) në datën e parë të shkruar lartë.

PËR DHE NË EMËR TË
REPUBLIKËS SË KOSOVËS

BESIM BEQAJ
MINISTËR I FINANCAVE

PËR DHE NË EMËR TË
BANKËS ISLAMIKE PËR ZHVILLIM

DR. AHMAD MOHAMED ALI
PRESIDENT

Aneksi -I PËRSHKRIMI I ASETIT

1. Projekti është i vendosur në Rrugën 6 të korridorit transportues të rrjetit Observator të Transportit të Evropës Jug Lindore (SEETO). Ky përbëhet nga përmirësimi i Rrugës Kryesore M2 që e lidh Prishtinën, kryeqytetin, me dy qytete të mëdha, atij të Vushtrrisë dhe Mitrovicës në drejtim të Veri Perëndimit. Rruga e vetme ekzistuese më nga një korsi në të dy anët do të përmirësohet në një rrugë të dyfishtë me dy korsi në një distancë totale prej 26.7km, që fillon nga Millosheva, 8km nga Prishtina, deri në hyrje të Mitrovicës.

2. Pjesa e financuar e Bankës është 4.55km e gjatë dhe përbëhet nga një anashkalim të qytetit të Vushtrrisë përgjatë një shtrirjeje të re që fillon 16.96km pas fillimit të punëve në Milloshevë, dhe duke përfunduar në dalje të qytetit të Vushtrrisë me një rreth për ndarjen e trafikut.

3. Kostoja totale e projektit është vlerësuar në Euro 87.04 milion duke mos i përfshirë tatimet e taksat doganore. Përveç Bankës dhe Pranuesit, Projekti është i bashkë financuar nga entitet tjera sipas dokumenteve të Projektit dhe sipas tabelës në vijim. Banka mbulon punët civile në 4.55 km të rrugës nga Km 16.95 deri në Km 21.51 e cila përbëhet nga një anashkalim të qytetit të Vushtrrisë dhe 100% të të gjitha komponentëve tjera (Shërbimet e Konsulencës, Mbështetje për Menaxhimin e Projektit, Funkcionalizmin e punëtorisë /familjarizimi dhe Auditimin Financiar) përveç për blerjen e tokës që mbulohet nga Pranuesi

Tabela-1: Vlerësimi i Kostos së Projektit & Plani i Financimit

Sr. Nr.	Komponentët e projektit	Banka		Bashkë financuesit		Pranuesi		Kostoja totale
		€Mn	%	€Mn	%	€Mn	%	
A.	Blerja e tokës	-	-	-	-	14.00	100.0%	14.00
B.	Punët civile	11.79	18.7%	28.32	45.0%	22.79	36.2%	62.91
C.	Shërbimet e Konsulencës	1.77	100.0%	-	-	-	-	1.77
D.	Menaxhimi i Projektit	0.38	100.0%	-	-	-	-	0.38
E.	Funksionalizimi i punëtorisë/familjarizimi	0.03	100.0%	-	-	-	-	0.03
F.	Auditimi financiar	0.04	100.0%	-	-	-	-	0.04
	Kostoja bazë	14.01	17.7%	28.32	35.8%	36.79	46.5%	79.13
	Rezervat fizike	0.42	17.7%	0.85	35.8%	1.10	46.5%	2.37
	Çmimi i rezervave	0.98	17.7%	1.98	35.8%	2.58	46.5%	5.54
	Totali	15.41	17.7%	31.16	35.8%	40.47	46.5%	87.04

Aneksi -II PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Komponentët e projektit janë si në vijim:

1. **Blerja e Tokës:** ky komponent përfshinë blerjen e të gjithë tokës së kërkuar dhe pasurisë së paluajtshme që është e nevojshme për përmirësimin e rrugës nga Qeveria e Kosovës, zhvendosja e shërbimeve publike dhe kompensimi i tokës dhe pronarëve të pasurisë në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 03/1-139, më datë 26.03.2010 “për Ekspropriimin e pasurisë së paluajtshme”. Kërkesat e vlerësuara kapin shumë prej 342,655 m² duke përfshirë 117,839m² të pasurisë private dhe 224,816m² të pasurisë shtetërore. Vlerësimi bruto i vlerës së tokës në pjesën që bashkë financohet nga Banka nga Millosheva deri në Vushtrri kap shumë prej €1 Milion.
2. **Punët Civile:** do t’i përfshijë të gjitha punët civile që kanë të bëjnë me përmirësimin e rrugës ekzistuese në një rrugë kryesore të dyfishtë me dy korsi në përputhje me standardet evropiane nga Lumi i Madh (PK7.165) deri në Mitrovicë (PK26.7). Artikuj kryesor të punës përfshijnë punët e dheut, shtresat e grimcuara të trotuareve, shtresat e stabilizuara, shtresa bituminoze, strukturat e mbajtjes, mure prej koshave me gurë, urave, kanaleve nën rrugë, sistemeve të drenazhit të pjesët anësore të rrugës, instalimit të mjeteve të sigurisë rrugore dhe punët e ndryshme. Dy korsit do të ndahen.
3. **Shërbimet e konsulencës:** Kompania e konsulencës do të kontraktohet për të performuar rishikimin e dizajnit të hollësishëm, përgatitjes së dokumenteve për tender për punët civile, për të asistuar Ministrinë e Infrastrukturës në vlerësimin e ofertave dhe për të zhvilluar mbikëqyrje të punëve në pjesën nga Lumi i Madh (PK7.2) deri në Vushtrri (PK21.5).
4. **Mbështetja për Menaxhimin e Projektit:** do të përfshijë shpenzimet dhe koston e publikimeve të dokumenteve të prokurimit të Njësisë për Menaxhimin e Projektit (NJMP) si vijon:
 - a) Shpenzimet e NJMP-së: përfshinë pagat e stafit të NJMP-së, kostot aktuale, dhe blerjen e pajisjeve të zyrës së NJMP-së (TI, mobile dhe dy automjete 4x4).
 - b) Gjithashtu, Kostoja e Njoftimit të Prokurimit të Përgjithshëm (NPP) dhe Njoftimit të Prokurimit të Veçantë (NPV), publikimeve për prokurimin e mallrave, punëve dhe shërbimeve, në një gazetë ndërkombëtare me tirazh të gjerë do të mbulohet nga Banka.
5. **Funksionalizimi i punëtorisë dhe vizita e familjarizimit,** për t’i mbuluar kostot e funksionalizimit të punëtorisë dhe vizitës së familjarizimit në IDB – HQ që do të organizohet për agjencionin ekzekutues dhe stafin kyç të NJMP-së në mënyrë që të trajnohen ata në procedurat e prokurimit dhe të disbursimit të Bankës.
6. **Auditimi Financiar i Projektit.** Një kompani lokale e auditimit me reputacion do të angazhohet për t’i audituar pasqyrat financiare të projektit dhe shfrytëzimin e alokimeve të buxhetit.

**Aneksi -III FORMA E OPINIONIT E AUTORITETIT KRYESOR LIGJOR
DHE/APO GJYQËSOR I QEVERISË SË RAEPUBLIKËS SË KOSOVËS**
[TË SHYTPET DHE TË OFROHET NË BALLINË]

Banka Islamike për Zhvillim,
P.O. Box: 5925, Jeddah 21432
Mbretëria e Arabisë saudite

Të nderuar zotërinj,

Në kapacitetin tim si **autoritet kryesor ligjor dhe/apo gjyqësor** i Republikës së Kosovës, sipas kompetencave që më janë dhënë sipas nenit ____ të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, me këtë vërtetohet se ky dokument përbën Opinionin Ligjor të lëshuar në lidhje me Marrëveshjet e Istisna'a dhe të Agjencionit më datë ___/___/___H (___/___/___G) të lidhur në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Islamike për Zhvillim (“**Marrëveshjet për financim**”) për punët e ndërtimit ashtu siç janë përshkruar në Aneksin I të këtyre Marrëveshjeve (“**Aseti**”) për shfrytëzim për përmirësimin e Rrugës Kryesore M2 Milloshevë–Mitrovica (“**Projekti**”) ë një shumë që nuk tejkalon €15,410.000.00 (Pesëmbëdhjetë Milion e Katërqind e Dhjetë Mijë Euro) përafërsisht që është ekuivalent me ID13,200,000.00 (Trembëdhjetë Milion e Dyqind Mijë Dinar islamik).

Për qëllimet e këtij Opinioni Ligjor, unë i kam ekzaminuar,

- (i) Marrëveshjen Kornizë mbi statusin dhe bashkëpunimin në lidhje veprimet e Bankës Islamike për Zhvillim në Republikën e Kosovës;
- (ii) Marrëveshjet për Financim;
- (iii) Autorizimet për nënshkrim dhe për të nënshkruar Marrëveshjen Kornizë si dhe marrëveshjet për Financim për dhe në emër të Republikës së Kosovës;
- (iv) Të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, urdhrat, dekretet dhe të tjera të Republikës së Kosovës; dhe
- (v) Dokumentet dhe instrumentet tjera të tilla të cilat i ka konsideruar të nevojshme.

Në përputhje me rrethanat, unë jam i mendimit se Marrëveshja Kornizë dhe Marrëveshjet për Financim të nënshkruara për dhe në emër të Republikës së Kosovës nga Shkëlqesia e tij z. **Ramadan Avdiu, Ushtrues detyre i Ministrit të Financave**, më ___/___/___H (___/___/___G):

- (a) Janë autorizuar, ekzekutuar, dorëzuar dhe ratifikuar ashtu siç duhet nga të gjitha veprimet e nevojshme korporate dhe qeveritare;
- (b) Nuk kërkojnë autorizime, pëlqime, licencë, përjashtim apo heqje dorë tjetër;
- (c) Nuk cenojnë ndonjë dispozitë të kushtetutës, ndonjë ligj, rregull, rregullore, urdhër a dekret të Republikës së Kosovës;

Prandaj, përbëjnë obligime ligjore dhe detyruese të Republikës së Kosovës në përputhje me kushtet e përgjithshme të përcaktuara në Marrëveshjet e përmendura

Duke pohuar atë më lartë, nuk shprehi ndonjë opinion tjetër përveç atij të ligjeve të Republikës së Kosovës.

NËNSHKRUAR në futi të dhënat më ___/___/___G.

Sinqerisht,

Nëshkrimi|Emri|Emërimi

**MARRËVESHJE E AGJENCIONIT
(ISTISNA'A)**

NË MES TË

REPUBLIKËS SË KOSOVËS

DHE

BANKËS ISLAMIKE PËR ZHVILLIM

**PËR
FINANCIMIN E PROJEKTIT PËR PËRMIRËSIMIN E
RRUGËS M2 MILLOSHEVË-MITROVICË**

Përmbajta

Neni -1	PËRKUFIZIMET – INTERPRETIMI	3
Neni -2	AGJENCIONI	6
Neni -3	PROKURIMI I MALLRAVE DHE SHËRBIMEVE	6
Neni -4	PËZGJEDHJA E KONTRAKTUESIT DHE KONSULENTIT	6
Neni -5	MENAXHIMI I KONTRATAVE	7
Neni - 6	DISBURSIMI I SHUMËS SË APROVUAR	8
Neni -7	MARRJA PËRSIPËR E ASETIT	9
Neni -8	PEZULLIMI, ANULIMI DHE NDËRPRERJA	9
Neni -9	PËFAQËSIMET	11
Neni -10	NGJARJET E DËSHTIMIT	11
Neni -11	DËMSPËRBLIMI	112
Neni -12	RAPORTET	13
Neni -13	HEQJE DORË	14
Neni -14	EFEKTIVITETI	14
Neni -15	LIGJI MBIZOTËRUES – ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE	14
Neni -16	BASHKËRENDIMI DHE NJOFTIMET	15
Neni -17	TË NDRYSHME	16
Faqja e ekzekutimit:	17
Aneksi -I	PËRSHKRIMI I ASETIT	18
Aneksi -II	PËRSHKRIMI I PROJEKTIT	19

MARRËVESHJE E AGJENCIONIT

Kjo Marrëveshje është lidhur më 12/07/1434H (që korrespondon me 22/5 2013G) në mes të Republikës së Kosovës si agent (këtu e tutje referohet si **“Pranuesi”**) dhe Bankës Islamike për Zhvillim (këtu e tutje referohet si **“Banka”**).

Pranuesi dhe Banka në mënyrë të përbashkët referohen si **“Palët”** dhe në mënyrë individuale si **“Pala”**.

Ndërsa,

- A. Pranuesi ka kërkuar nga Banka që të financoj ndërtimin e punimeve të përcaktuara në Aneksin –I (këtu e tutje referohet si **“Aseti”**) për përmirësimin e rrugës kryesore M2 Milloshevë – Mitrovicë (këtu e tutje referohet si **“Projekti”**) ashtu siç përshkruhet në Aneksin – II;
- B. Bordi i Drejtorëve Ekzekutiv i Bankës më ____/____/____ H (që korrespondon me ____ / ____ / ____ /2013G), ka aprovuar një shumë që nuk tejkalon €15,410.000.00 (pesëmbëdhjetë milion e katër qind e dhjetë mijë euro) përafërsisht që është ekuivalent me ID13,200,000.00 (trembëdhjetë milion e dy qind mijë dinar islamik) për ndërtimin e Asetit për Projektin përmes Istisna’a;
- C. Banka është pajtuar me marrëveshjen e datës së njëjtë (këtu e tutje referohet si **“Marrëveshja e Istina’s”**) për të ndërtuar Asetin për Pranuesin, në kapacitetin e tij si blerës.

Prandaj, tani, Banka dhe Pranuesi më këtë pajtohen si në vijim:

Neni -1 PËRKUFIZIMET – INTERPRETIMI

1.1 Në këtë marrëveshje, përveç nëse konteksti kërkon ndryshe, termat si në vijim do të kenë kuptimin e atyre që jepet kundrejt tyre sikur këtu të shënuar poshtë:

Shuma e aprovuar :	Shuma e saktësuar në përshkrimin - B lartë.
Aseti:	Asetet e përmendura në Aneksin - I.
Kostoja kapitale :	Kostoja totale e ndërtimit të Asetit e cila do të përfshijë Çmimin e Kontratës dhe ndonjë kosto tjetër apo shpenzim që shkaktohet nga Banka në apo në lidhje me ndërtimin e Asetit plus një normë qarkulluese e shënjimit për 6 muaj EURIBOR plus 155 pikë bazë në vit që aplikohet në secilin Disbursim gjatë Periudhës së Zhvillimit.
Marrëveshja e Konsulencës:	Marrëveshja për bashkërendimin e ndërtimit të Asetit e lidhur në mes të Pranuesit dhe Konsulentit sipas nenit – 4.
Konsulenti:	Kompania konsulente apo konsulenti individual duhet të caktohet në përputhje me Nenin – 4.
Kontrata :	Kontrata për ndërtimin e Asetit e lidhur në emër të Bankës nga Pranuesi me Kontraktuesin.

Çmimi i kontratës :	Shuma e pagueshme për kontraktuesin për ndërtimin e Asetit.
Kontraktuesi:	Kontraktuesi të cilit i besohet ndërtimi i Asetit.
Data e disbursimit të parë:	Data, në të cilën Banka e bën disbursimin e parë sipas Kontratës, apo Konsulentit, cilado qoftë më herët.
Disbursimi:	Pagesa aktuale e ndonjë pjese të Shumës së Aprovuar sipas kësaj Marrëveshjeje.
Data efektive:	Data kur Banka e deklaron këtë Marrëveshje apo Marrëveshjen e Istisna' a (sido që ta kërkoj rasti) efektive në përputhje me Nenin -14.
Agjencioni ekzekutues:	Ministria e Infrastrukturës .
Certifikata përfundimtare e pranimit:	Certifikata e lëshuar nga Konsulenti në përputhje me kushtet e Kontratës që tregon se ndërtimi i Asetit është kryer kënaqshëm nga Kontraktuesi.
Periudha e zhvillimit:	Periudha që fillon në datën e Disbursimit të parë dhe që përfundon tre (3) vite pas kësaj.
Certifikata preliminare e pranimit:	Certifikata që lëshohet nga Konsulenti në përputhje me kushtet e kontratës që tregon se ndërtimi i Asetit është kryer kënaqshëm nga Kontraktuesi.
Projekti:	Ka kuptimin i cili i është dhënë atij në Përshkrimin A më lartë.
Praktikat e sankionueshme:	Secila nga praktika e korruptuar, praktika detyruese, praktika e fshehtë, praktika mashtruese apo praktika obstruktive ashtu siç definohet më poshtë: <ul style="list-style-type: none"> (a) Praktikë e korruptuar: nënkupton ofrimin, dhënien, pranimin, apo detyrimin direkt apo indirekt, çfarëdo qoftë me vlerë që në mënyrë të pahijshme të ndikojë veprimet e palës tjetër; (b) Praktikë detyruese: nënkupton secilin veprim apo mosveprim që pengon a dëmton, apo kërcënon të pengoj a të dëmtoj, direkt a indirekt, çfarëdo pale apo pronën e palës që të ndikoj në mënyrë të pahijshme në veprimet e Palës. (c) Praktikë e fshehtë: nënkupton një aranzhim në mes të dy a më shumë palëve të dizajnuara për të arritur një qëllim të pahijshëm, duke përfshirë ndikimin e pahijshëm në veprimet e palës tjetër. (d) Praktikë mashtruese: nënkupton një veprim a mosveprim, duke përfshirë keq përfaqësimin, që me dashje a nga pakujdesia lajthit, apo përpiqet të lajthit, Palën për të fituar përfitim financiar apo tjetër apo për t'iu shmangur obligimit. (e) Praktikë obstruktive: nënkupton ,

- (i) Qëllimisht shkatërron, falsifikon, ndryshon apo fsheh materialin e dëshmisë për hetim apo bërjen e dëshmive falsë para hetuesve, në mënyrë që të pengoj materialisht hetimin e Bankës në ruajtjen e praktikës së korruptuar, mashtruese, detyruese apo të fshehtë, dhe/apo kërcënon, shqetëson apo shantazhin ndonjë palë për të parandaluar atë nga shpalosja e çështjeve njohura që janë relevante për hetim apo nga ndjekja e hetimit, apo
- (ii) Veprimet që kanë për qëllim që materialisht të pengojnë ushtrimin e qasjes së Bankës në informatat e kërkuara me kontratë në lidhje me hetimin e Bankës në ruajtjen e praktikës së korruptuar, mashtruese, detyruese apo të fshehtë.

Tatimi:

Çfarëdo tatimi, ngarkese tatimore, taksë, taksë doganore apo ndonjë ngarkesë me natyrë të njëjtë (duke përfshirë pa kufizim secilin ndëshkim që është i pagueshëm në lidhje me ndonjë dështim për ta paguar apo vonesë në pagesën e ndonjë pagesë të ngjashme).

1.2 Interpretimi:

- (i) “aneksi”, “skeda”, duke iu nënshtruar ndonjë indikacioni të kundërt, do të interpretohet si referencë në aneks, skedë të Marrëveshjes apo dokument ku një referencë e tillë shfaqet;
- (ii) “përfshirë” do të interpretohet si referencë në “përfshirë, pa kufizim”;
- (iii) “ligji” do të interpretohet si cilido do ligj (duke përfshirë ligjin e zakonshëm a zakonor), statutin, kushtetutën, dekretin, vendimin, traktatin, rregulloren, direktivën, urdhëresën, urdhrin apo ndonjë masë tjetër legjislative të ndonjë organi a gjykate qeveritare, mbinacionale, qeverisë lokale, statutore dhe rregullatore;
- (iv) Kjo Marrëveshje apo ndonjë marrëveshje a dokument tjetër do të interpretohet si referencë në këtë Marrëveshje apo, siç mund të jetë rasti, një marrëveshje apo dokument tjetër i tillë ngase i njëjti mund të ketë qenë, apo që herë pas here, mund të amendamentohet, të ndryshohet, të shënohet apo të plotësohet;
- (v) “Neni”, “seksioni”, “paragrafi, or “preambula”, përveçqë nëse shfaqet një indikacion i kundërt, do të interpretohet si një në këtë apo ndaj kësaj Marrëveshjeje;
- (vi) Titujt në këtë Marrëveshje janë vetëm për përshtatshmëri dhe nuk mëtojnë, dhe nuk do të interpretohen, për të ndryshuar, kufizuar, apo rritur fushëveprimin apo kuptimin e gjuhës që e përmban kjo Marrëveshje;
- (vii) Njëjësi e përshin shumësin dhe anasjelltas;
- (viii) “dita” dhe “viti” do të jenë dita, muaji, viti, përkatësisht kalendari Gregorian; dhe

- (ix) Fjalët dhe shprehjet e përcaktuara në Marrëveshjen e Istisna'a dhe të cilat nuk janë përcaktuar këtu do të kenë të njëjtin kuptim si ai i dhënë në Marrëveshjen e Istisna'a.

Neni -2 AGJENCIONI

Me anë të kësaj Banka e cakton Pranuesin si agjentin e saj për të lidhur Kontratë dhe Marrëveshje Konsulente, dhe për të mbikëqyrur ndërtimin e Asetit, dhe me anë të kësaj Pranuesi pajtohet me këtë caktim.

Neni -3 PROKURIMI I MALLRAVE DHE SHËRBIMEVE

3.1 Pranuesi, në konsultim me Bankën dhe në përputhje me procedurat e Bankës dhe Udhëzimet për Prokurimin e Mallrave dhe Punëve dhe/apo Udhëzimet për Shfrytëzimin e Konsulentëve, siç mund të jetë rasti, dhe duke iu nënshtruar aprovimit të Bankës, do t'i jap të gjitha kontratat që financohen sipas kësaj Marrëveshjeje për ekzekutimin e Projektit si në vijim:

- (i) Kontraktuesi do të përzgjidhet përmes një Ofertimi Konkurrues Ndërkombëtar (OKN) me para kualifikim të ofertuesve.
- (ii) Konsulenti do të përzgjidhet nga lista e ngushtë prej 6 deri në 8 kompani ndërkombëtare të konsulencës sipas metodës së Përzgjedhjes së bazuar në Cilësi dhe Kosto (QCBS).
- (iii) Stafi i Njësisë për Menaxhimin e Projektit (NJMP) që do të themelohet në kuadër të Agjencionit Ekzekutues do të përzgjidhet na baza konkurrese përmes krahasimit të kualifikimeve në minimum të tre ekspertëve lokal për secilën pozitë. Për më tepër, pajisjet e zyrës dhe automjetet e NJMP-së do të prokurohen përmes blerjes kombëtare.
- (iv) Auditori financiar i projektit do të përzgjidhet nga lista e ngushtë e kompanive lokale të auditimit bazuar në përzgjedhjen me koston më të ultë.
- (v) Pranuesi do t'i shfrytëzoj Dokumentet e Standarde të Bankës për Prokurim për komponentët e financuara apo të bashkë financuara nga Banka dhe do të marr një aprovim paraprak të Bankës dhe nga bashkë financuesit në secilën fazë të prokurimit, si edhe në dhënien e kontratës dhe në fazat e administrimit të kontratës.

3.2 Pranuesi do të siguroj apo do të shkaktoj që të siguroj që dispozitat e anti korrupsionit dhe ato të anti-mashtrimit të pranueshme për Bankën të përfshihen në të gjitha dokumentet dhe kontratat e ofertimit, duke përfshirë dispozitat të cilat saktësojnë të drejtën e bankës për të audituar dhe ekzaminuar regjistrat dhe llogaritë e agjencioneve ekzekutuese dhe implementuese dhe të të gjithë kontraktuesve, furnizuesve, konsulentëve dhe ofruesve tjerë të shërbimeve atyre që kanë të bëjnë me Projektin.

Neni -4 PËRZGJEDHJA E KONTRAKTUESIT DHE KONSULENTIT

4.1 Pranuesi, në emër të Bankës, do të negocioj dhe do të lidh Kontratë me Kontraktuesin duke iu nënshtruar si në vijim:

- (i) Kushtet e përgjithshme të Kontratës do të pajtohen në mes të Bankës dhe Pranuesit.
 - (ii) Sipas planit të aprovuar të financimit, kontributi i Bankës për Çmimin e Kontratës nuk do të tejkalojë €1,790,000.00 (Njëmbëdhjetë Milion e Shtatëqind e Nëntëdhjetë Mijë Euro).
 - (iii) Periudha për përfundimin e ndërtimit të Asetit sipas Kontratës nuk do të tejkalojë 36 (tridhjetë e gjashtë) muaj nga data e Disbursimit të Parë.
 - (iv) Specifikacionet e Asetit sipas Kontratës do të jenë sikur ato që janë përshkruar shkurtë në Aneksin – I dhe të detajuara në Kontratë.
 - (v) Pas përfundimit, Aseti do të merret përsipër direkt nga Pranuesi.
 - (vi) Aprovimi me shkrim i Bankës për kushtet e përgjithshme të Kontratës së negociuar do të merret para se të lidhet Kontrata nga Pranuesi.
 - (vii) Kontrata do të përcaktoj se Kontraktuesi do të prokuroj sigurimin e të gjitha rreziqeve të kontraktuesit si **klent në tregti**, dhe shumat e sigurimit do të paguhën në Bankë në Euro, Dollar Amerikan apo në ndonjë valutë tjetër të pranueshme.
- 4.2 Pranuesi, në emër të Bankës, do të negocioj dhe do të lidh një Marrëveshje Konsulencë me Konsulentin duke iu nënshtruar si në vijim:
- (i) Konsulenti do të jetë përgjegjës për të verifikuar të gjitha kërkesat e Disbursimit që do t'i dorëzohen Bankës. Konsulenti gjithashtu do të jetë përgjegjës për të koordinuar të gjitha aktivitetet, për të ofruar raporte të rregullta të progresit, dhe do të siguroj që të gjitha politikat dhe procedurat e Bankës të përcillen saktësisht gjatë tërë ndërtimit të Asetit.
 - (ii) Termat e referencës së Konsulentit do të pajtohen me shkrim në mes të Pranuesit dhe Bankës para ftesës së propozimeve nga konsulentët e listës së ngushtë.
 - (iii) Pranuesi do të shoqëroj Bankën në negociata me Konsulentin e përzgjedhur; rezultati i së cilës do t'i nënshtrohet aprovimit final të Bankës dhe Pranuesit.
- 4.3 Për t'iu shmangur dyshimit, dhe pa paragjykuar obligimet tjera të Agjencionit Ekzekutues sipas kësaj Marrëveshjeje, Agjencioni Ekzekutues do t'i kryej obligimet e përcaktuara në Nenin 3 dhe 4 në emër të Pranuesit.

Neni -5 MENAXHIMI I KONTRATAVE

- 5.1 Pranuesi merr përsipër që gjatë menaxhimit të Kontratës, do të ushtroj standardin më të lartë të zellit e kujdesit në monitorimin e saktë dhe korrekt të performancës nga Kontraktuesi i obligimeve të tij sipas Kontratës duke pasur parasysh sigurimin që Aseti do të ndërtohet në përputhje me specifikacionet brenda kohës dhe për çmimin i cili është përcaktuar në Kontratë.
- 5.2 Pranuesi, pa pëlqimin paraprak me shkrim nga Banka, nuk do të bëj ndonjë amandamentim, ndryshim apo modifikim të Kontratës e cila mund të,
- (i) Rezultojë në ngritjen e Çmimit të Kontratës; apo
 - (ii) Rezultojë në zgjatjen e datës së përfundimit; apo
 - (iii) Rezultojë në ndryshim të specifikacionit, apo

- (iv) Të mos jetë në përputhje me praktikën e zakonshme të mirë.
- 5.3 Pa paragjykuar parimet e përgjithshme të Nenit 5.1, Pranuesi do të jetë i obligueshëm të:
- (i) Këshilloj Bankën, sa më shpejtë që të jetë e praktikueshme, për ndonjë vonesë apo vonesë të parashikuar në përfundimin e ndërtimit të Asetit më të gjitha hollësitat në të;
 - (ii) Të merret me të gjitha çështjet rregullatore dhe administrative që lidhen me ndërtimin e Asetit në përputhje me ligjet përkatëse në Republikën e Kosovës.
 - (iii) Nënshkruaj Certifikatën Preliminare të Pranimit dhe Certifikatën Përfundimtare të Pranimit nëse është i kënaqur që Aseti në fazën përkatëse është ndërtuar në përputhje me Kontratën duke përfshirë specifikacionet.
- 5.4 Nëse duke shkelur Nenin -5, Pranuesi i jep udhëzime Kontraktuesit si rezultat i së cilës ka ngritje të Çmimit të Kontratës apo Banka mbahet përgjegjëse për ndonjë Palë për ndonjë kërkesë, humbje, dëmtim apo shpenzim, atëherë Pranuesi pajtohet që të bart ngritjen në Çmimin e Kontratës apo, siç mund të jetë rasti, që të dëmshpërblej Bankën për ndonjë kërkesë të tillë, humbje, dëmtim apo shpenzim.
- 5.5 Është pajtuar që Pranuesi do të ofroj një numër të tillë të personelit siç mund të jetë e nevojshme për t'i zbatuar detyrat e tij sipas kësaj Marrëveshjeje dhe sipas Kontratës.
- 5.6 Pranuesi nuk do të ketë të drejtë në asnjë shpërblim apo pagesë tjetër nga Banka në lidhje me apo që del nga caktimi i Pranuesit si agjent i Bankës sipas kësaj Marrëveshjeje.

Neni -6 DISBURSIMI I SHUMËS SË APROVUAR

- 6.1 Banka do të disbursoj shumën e aprovuar në aso mënyre që është përcaktuar në Kontratë dhe në përputhje me Procedurat për Disbursim të Bankës.
- 6.2 **Data për Kërkimin e Disbursimit të Parë:** Nëse brenda 180 (Njëqind e tetëdhjetë ditëve) nga data efektive, apo një datë të tillë të mëvonshme siç do të merret vesh në mes të Pranuesit dhe Bankës, Pranuesi nuk i ka dorëzuar kërkesën Bankës për të bërë Disbursimin e parë, Banka mund të ndërpres këtë Marrëveshje me njoftimin e duhur të dhënë Pranuesit.
- 6.3 **Data Përmbyllëse e Disbursimit:** 31/12/2016G, apo një date e tillë e mëvonshme siç do të merret vesh në mes të Pranuesit dhe Bankës është data përmbyllëse e tërheqjes sipas kësaj Marrëveshjeje.
- 6.4 Pa paragjykuar parimin e përgjithshëm në Nenin 6.1, Pranuesi do të:
- (i) ofroj një kopje të nënshkruar të Marrëveshjes së Konsulencës, kur të dorëzohet aplikacioni për Disbursimin e parë në favor të Konsulentit.
 - (ii) Ofroj një kopje të nënshkruar të Kontratës (nëse nuk është dorëzuar më herët) dhe një kopje të policës së sigurimit, kur të dorëzohet aplikacioni për Disbursimin e parë sipas Kontratës.
- 6.5 Konsulenti do t'i verifikoj të gjitha kërkesat për Disbursim që do t'i dorëzohen Bankës.

- 6.6 Banka nuk do të jetë e obligueshme që të bëjë kurrfarë Disbursimi nga kjo nëse aplikacioni për Disbursim nuk është në përputhje me këtë Marrëveshje apo nëse dokumentet e dorëzuara nga Pranuesi janë të pa kompletuara apo ndryshe të dëmtuara. Pranuesi do të jetë përgjegjës për ndonjë vonesë në pagesën e Disbursimit nëse vonesa e tillë është për shkak se aplikacioni nuk është në përputhje me këtë Marrëveshje apo për shkak të pamjaftueshmërisë apo mospërputhjes me dokumentet e kërkuara.
- 6.7 Për qëllime të asistimit të Pranimiit në regjistrimin e borxhit të saj apo menaxhimin e proceseve, Banka do të njoftoj Pranimin e secilit Disbursim që paguhet nga Shuma e Aprovuar.

Neni -7 MARRJA PËRSIPËR E ASETIT

- 7.1 Është pajtuar se Kontrata do të ofroj marrjen përsipër të Asetit direkt pas përfundimit nga Pranuesi. Gjithashtu është pajtuar se në asnjë rast, Banka nuk do të jetë përgjegjëse ndaj Pranuesit për ndonjë humbje që rezulton nga ndonjë vonesë në marrjen përsipër të Asetit.
- 7.2 Për t'iu shmangur dyshimit, është pajtuar se nëse Pranuesi, pas nënshkrimit të Certifikatës Përfundimtare të Pranimiit, refuzon që të marr përsipër Asetin nga Kontraktuesi, për çfarëdo arsye cilado qoftë ajo, Pranuesi do të dëmshpërblej Bankën për secilën kosto, shpenzim apo humbje që rezulton nga kjo.

Neni -8 PEZULLIMI, ANULIMI DHE NDËRPRERJA

- 8.1 Nëse Kontrata nuk nënshkruhet brenda 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditëve nga Data Efektive e kësaj Marrëveshjeje, Banka, duke njoftuar Pranuesin, mund të anuloj Shumën e Aprovuar, përveç nëse është e kënaqur me arsyetimin e Pranuesit për një vonesë të tillë.
- 8.2 Pranuesi mund të kërkoj nga Banka të ndërpres këtë Marrëveshje dhe të anuloj Shumën e Aprovuar në çfarëdo kohe para nënshkrimit të kësaj kontrate.
- 8.3 Nëse në çfarëdo kohe Banka vendos, pas konsultimit me Pranuesin, se ndonjë pjesë e Shumës së Aprovuar nuk do të kërkohet për të financuar Projektin, Banka mund t'i jap njoftim Pranuesit duke ndërprerë këtë ndërmarrje nga Banka për disbursimin e një pjese të tillë.
- 8.4 Pas dorëzimit të Asetit dhe lëshimit të Certifikatës Përfundimtare të Pranimiit, do të ushtrohen obligimet e Agjencionit të Pranuesit këtu poshtë.
- 8.5 Banka, duke i dhënë njoftim Pranuesit, mund të pezulloj a ndërpres këtë Marrëveshje dhe të pezulloj a anuloj Shumën e Aprovuar apo ndonjë pjesë nga kjo në secilin nga rastet si në vijim:
- (a) Një situatë e jashtëzakonshme do të ketë ndodhur e cila,
- (i) Do ta bëjë atë, sipas mendimit të Bankës, të pamundshme që Pranuesi do të jetë në gjendje për t'i përmbushur obligimet sipas kësaj Marrëveshjeje, apo

- (ii) Do të parandaloj arritjen e qëllimeve për të cilat kjo Marrëveshje është lidhur.
 - (b) Një përfaqësim që bëhet nga Pranuesi apo ndonjë deklaratë e dorëzuar apo që mëtohet të ketë mbështetje nga Banka në procedimin e Projektit për aprovim apo për lidhjen e kësaj Marrëveshjeje, do të ketë qenë jo e kompletuar apo e pasaktë në secilin pikëpamje materiale;
 - (c) Banka përcakton se –
 - (i) Pranuesi është në shkelje të obligimeve të tij sipas kësaj Marrëveshjeje, apo
 - (ii) Në lidhje me prokurimin e ekzekutimit të ndonjë Kontrate që do të financohet plotësisht apo pjesërisht nga shumët e financimit sipas kësaj Marrëveshjeje, nëse ndonjë person apo entitet është angazhuar në ndonjë Praktikë të Sanksionueshme para se Pranuesi të ketë ndërmarr ndonjë veprim me kohë apo të përshtatshëm që është i kënaqshëm për Bankën për të korrigjuar situatën apo për të adresuar praktikatat e tilla kur ato të ndodhin.
 - (d) Pranuesi ka dështuar në ushtrimin e obligimeve të tij për të paguar ndonjë shumë që është për t'u paguar Bankës (apo ndonjë dege të Bankës).
- 8.6 Secili pezullim i Marrëveshjes do të vazhdoj gjersa ngjarja apo ngjarjet të cilat shkaktojnë një pezullim të tillë do të kenë pushuar së ekzistuari apo gjersa Banka do të ketë njoftuar Pranuesin se ndërmarrja e Bankës për ndërtimin e Asetit është rivendosur, cilado qoftë të jetë më herët; megjithatë, me kusht që në rast të ndonjë njoftimi të tillë të rivendosur, ndërmarrja për të ndërtuar Asetin do të rivendoset vetëm deri në atë masë dhe duke iu nënshtuar kushteve të saktësuara në një njoftim të tillë, dhe asnjë njoftim i tillë nuk do të ndikoj apo pengoj ndonjë të drejtë, kompetencë a korrigjim të Bankës në lidhje me ndonjë ngjarje tjetër apo të më pastajme që është përshkruar në këtë Nen.
- 8.7 Në rast se Kontraktuesi dështon t'i përmbush ndonjë nga obligimet e veta sipas Kontratës dhe Pranuesi, në konsultim me Bankën, e ndërprente Kontratën në përputhje me kushtet e saja, ndërprerja e tillë, pas 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga ndërprerja e tillë, do të veproj si anulim i ndonjë shume që ka mbetur e pa disbursuar nga Shuma e Aprovuar, përveç nëse Banka pajtohet ndryshe. Pavarësisht nga ndërprerja e kësaj Marrëveshjeje, Pranuesi do të vazhdoj të bashkë veproj me dhe të asistoj Bankën për të kthyer nga Kontraktuesi një pjesë të tillë Çmimit të Kontratës dhe ndonjë shumë tjetër që mund të jetë disbursuar nga Banka para ndërprerjes së Kontratës.
- 8.8 Anulimi i Shumës së Aprovuar apo ndonjë pjesë nga kjo nuk do të ndikoj ndonjë zotim të bërë, obligime të shkaktuara apo të drejtat e shtuara para datës së anulimit.
- 8.9 Përveç nëse Disbursimi është bërë nga Shuma e Aprovuar, nëse Shuma e Aprovuar anulohet, Marrëveshja do të konsiderohet automatikisht e ndërprerë.
- 8.10 Pjesa e pa disbursuar e Shumës së Aprovuar automatikisht do të anulohet në rast të ndërprerjes së kësaj Marrëveshjeje apo Marrëveshjes Istitucionale.
- 8.11 Pas anulimit të Shumës së Aprovuar apo ndonjë pjesë nga kjo dhe/apo ndërprerjes së kësaj Marrëveshjeje për shkak të Ngjarjes së Dështimit, apo shkeljes

nga Pranuesi të obligimeve të tij sipas kësaj Marrëveshjeje dhe/apo dështimit për të siguruar ofrimin e Asetit, Pranuesi do të shpërblej Bankën me një shumë të barabartë me Koston kapitale dhe me zotimin e vendosur apo të shkaktuar, që nga data e ndërprerjes.

8.12 Kjo Marrëveshje do të ndërpritet automatikisht pas ndërprerjes së Marrëveshjes Istisna'a apo anulimit të Shumës së Aprovuar sipas Marrëveshjes Istisna'a.

Neni -9 PËRFAQËSIMET

Pranuesi përfaqëson dhe garanton se:

- (i) Të gjitha autorizimet qeveritare dhe veprimet e nevojshme për autorizim apo që kërkohen për vlefshmërinë apo zbatueshmërinë e obligimeve të parashikuara sipas kësaj Marrëveshjeje kundër Pranuesit janë marrë apo janë kryer dhe janë valide dhe vlejné e janë në fuqi dhe efekt të plotë.
- (ii) Sipas ligjeve në fuqi të Republikës së Kosovës në datën e kësaj Marrëveshjeje, pohimet e bankës kundër Pranuesit sipas kësaj Marrëveshjeje do të radhiten së paku *pari passu* me pohimet e të gjithë kreditorëve tjerë të pasigurt për ndonjë borxh të Pranuesit; dhe
- (iii) Autoriteti në fjalë, departamenti dhe/apo njësia e ngarkuar me shërbimin e borxhit të jashtëm për dhe në emër të Pranuesit është udhëzuar për të bërë pagesën e kësteve të Çmimit të Ulur në datat për pagesë.

Neni -10 NGJARJET E DËSHTIMIT

10.1 Nëse njëra nga ngjarjet e saktësuara në këtë nen do të ketë ndodhur dhe vazhdon të ndodh atëherë Banka, duke i dhënë njoftim Pranuesit, mund të deklaroj tërë apo një pjesë të Çmimit të Shitjes që është, dhe e njëjta me anë të kësaj do të bëhet, menjëherë për pagesë dhe e pagueshme (çdo gjë në këtë Marrëveshje pavarësisht) pa ndonjë njoftim tjetër:

- (a) Dështimi do të ketë ndodhur në pagesën e ndjenë kësti të Çmimit të Shitjes dhe dështimi i tillë do të ketë vazhduar për një periudhë prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve.
- (b) Dështimi, përveç dështimit të saktësuar në Nenin 10.1 (a), do të ketë ndodhur në performancën e ndonjë obligimi të Pranuesit sipas kësaj Marrëveshjeje dhe secila nga këto dështime do të ketë vazhduar për një periudhë prej 30 (tridhjetë) ditëve.
- (c) Çfarëdo përfaqësimi apo garantimi i konfirmuar apo i bërë nga Pranuesi në lidhje me ekzekutimin dhe ofrimin e kësaj Marrëveshjeje, apo në lidhje me ndonjë kërkesë për disbursim sipas kësaj Marrëveshjeje, do të konstatohet se është jo korrekte në secilin pikëpamje materiale dhe do të vazhdoj të jetë jo korrekte për një periudhë prej 30 (tridhjetë) ditëve pas njoftimit që nga kjo t'i jetë dhënë Pranuesit nga Banka;
- (d) Pranuesi nuk do të jetë në gjendje për të paguar borxhet e tij pasi që atyre u skadon afati apo ndryshe borxhet janë bërë të paaftha për pagesë; apo ndonjë mbajtës i garancisë ligjërisht të ketë marrë posedimin apo pranuesi apo administruesi i besuar të jetë caktuar për tërë apo për një pjesë të ndërmarrjes

apo asetëve të Pranuesit; apo garanci apo ekzekutim (apo proceseve të ngjashme) do të vihet tatim apo do të zbatohen pas a do të lëshohen kundrejt ndonjë pasurie të paluajtshme apo pasurie të Pranuesit dhe se garancia apo ekzekutimi i tillë nuk do të ushtrohen brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve; apo të jetë bërë një urdhër apo një rezolutë e suksesshme të jetë kaluar apo procedurat e ngjashme merren për likuidimin e Pranuesit, falimentimin apo shpërbërjes; apo ndonjë ngjarje tjetër do të ketë ndodhur e cila sipas ndonjë ligji të aplikueshëm do të kishte një efekt të ngjashëm me ndonjë nga ato ngjarjet e dhëna në listë në këtë paragraf;

- (e) Ndonjë dispozitë e kësaj marrëveshjeje është apo bëhet jo valide, e paligjshme apo e pa zbatueshme;

10.2 Nëse do të ketë ndodhur ndonjë Ngjarje e **dështimit** apo ndonjë ngjarje e cila me kalimin e kohës apo njoftimit dhe me kalimin e kohës do të bëhet një Ngjarje e Dështimit, Pranuesi menjëherë do t'i jepte Bankës një njoftim me anë të kësaj duke saktësuar natyrën e një Ngjarjeje të tillë të dështimit apo ngjarja e tillë dhe ndonjë hap që Pranuesi po i ndërmerr për të korrigjuar të njëjtën.

10.3 Asnjë veprim i ndërmarrjes dhe asnjë vonesë në ushtrimin, apo dështimin për të ushtruar, ndonjë të drejtë, kompetencë apo korrigjim që i shkaktohet Bankës pas ndonjë dështimi sipas kësaj Marrëveshjeje apo ndonjë marrëveshjeje të tillë, nuk do të pengoj ndonjë të drejtë, kompetencë apo korrigjim apo nuk do të interpretohet se heq dorë nga kjo apo pranim i heshtur në të; e as veprimi i Bankës në lidhje me ndonjë dështim të tillë, apo ndonjë pranim të heshtur nga ajo aty nuk do të ndikoj apo pengoj ndonjë të drejtë, kompetencë apo korrigjim të Bankës në lidhje me ndonjë dështim tjetër.

Neni -11 DËMSHPËRBLIMI

11.1 Pranuesi me këtë ndërmerr të dëmshpërblej Bankën, në bazë neto pas heqjes së taksave (në normën tatimore të aplikueshme lokale dhe të huaja) kundrejt, dhe pajtohet të mbroj, ruaj dhe të mbaj të padëmshme Bankën nga ndonjë obligim apo nga të gjitha obligimet, tarifat, detyrimet, humbjet, dëmshpërblimet, ndëshkimet, kërkesat, veprimet, vendimet dhe shpenzimet duke i përfshirë tarifat dhe shpenzimet e arsyeshme ligjore (duke i përfshirë tarifat dhe shpenzimet e tilla ligjore që janë shkaktuar në lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje), të secilit lloj dhe natyrë çfarëdo qoftë ajo e imponuar, e shkaktuar, apo e pohuar kundrejt Bankës që del nga:

- (a) Pronësia, posedimi, shfrytëzimi, dokumentimi, largimi, kthimi apo aplikimet tjera apo dispozitat sipas Kontratës apo Marrëveshjes së Konsulencës, duke i përfshirë të tillat siç mund të dalin nga:
 - (i) Ndonjë humbje apo dëmtim të ndonjë pasurie apo vdekje e lëndim ndaj ndonjë personi;
 - (ii) Defektet e dukshme apo të fshehura në Aset:
 - (iii) Ndonjë kërkesë sipas detyrimit rigoroz si veprim i dëmshëm apo ndryshe;
 - (iv) Çfarëdo kërkesë bazuar në shkeljen e patentës, markës dhe të drejtës së autorit;
 - (v) Ndonjë kërkesë bazuar në detyrimin që del sipas ligjeve të aplikueshme mjedisore apo aprovimeve mjedisore;

- (vi) Ndonjë kërkesë në lidhje me titullin e asetit apo tokën në të cilën kjo ndërtohet;
 - (vii) Ndonjë kërkesë apo kontest në lidhje me kontratën apo ndonjë Letër Kredie që është vendosur sipas asaj apo në lidhje me marrëveshjen e Konsulencës.
- (b) Ndodhia e ndonjë dështimi apo ndonjë dështim tjetër në lidhje me Pranuesin apo Kontraktuesin për të performuar apo për të respektuar ndonjë kusht të kësaj Marrëveshjeje, apo ndonjë dokument, marrëveshje apo kontratë e lidhur në lidhje me këtë në apo ndryshe në lidhje me Asetin, por duke përjashtuar ndonjë kërkesë bazuar në ndonjë dështim në lidhje me Bankën për t'i respektuar obligimet e saj sipas kësaj Marrëveshjeje apo ndonjë dokument, marrëveshje apo kontratë e lidhur nga Banka në lidhje me këtë apo ndryshe në lidhje me Asetin;
- (c) Ndonjë kërkesë, person në ngarkim, interesat e sigurisë dhe pengimet apo proceset ligjore në lidhje me titullin për apo interesin në Aset apo në tokën ku kjo ndërtohet.

11.2 Pranuesi do t'i jap Bankës një njoftim të menjëhershëm për ndonjë ndodhi apo kusht të njohur për Pranuesin si pasojë e së cilës Banka është apo ka të ngjarë arsyeshëm të ketë të drejtën për dëmshpërblim. Dëmshpërblimi i dhënë në Nenin – 11.1 në veçanti do të aplikohet dhe do të përfshij kërkesat apo veprimet të shkaktuara nga apo në emër të punonjësve të pranuesit dhe me këtë Pranuesi në mënyrë të qartë heq dorë, sikur kundër bankës, çfarëdo imuniteti për të cilin Pranuesi ndryshe mund të ketë të drejtë sipas ndonjë ligji të aplikueshëm. Pranuesi menjëherë pas kërkesës nga Banka (por në secilin rast brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve të kërkesës së tillë) do të rimbursoj Bankën për shumën e shpenzuara nga ajo në lidhje me ndonjë të përmendur apo do të paguaj një shumë të tillë direkt. Pranuesi do të zëvendësohet për të drejtat e Bankës në ndonjë mënyrë në lidhje me të cilën Pranuesi në fakt ka rimbursuar Bankën për shumën e shpenzuara nga ajo apo në fakt i ka paguar shumën e tilla direkt sipas Nenit -11.1. Në rast se ndonjë veprim apo procedurë vihet para bankës në lidhje me kërkesën e dëmshpërblyer, Banka, pas pranimit të njoftimit për fillimin e një veprimi apo procedure të tillë, do të njoftoj Pranuesin me anë të kësaj, duke bashkëmbyllur një kopje të letrave që i janë shërbyer Bankës. Pranuesi mund, dhe me kërkesë të Bankës, do të rezistoj dhe mbroj një veprim të tillë apo procedurë me shpenzimet e pranuesit, apo do të shkaktoj të njëjtin të rezistoj apo të mbrohet përmes avokatit të zgjedhur nga Pranuesi që është arsyeshëm i kënaqshëm për Bankën. Në rast të ndonjë dështimi nga pranuesi për të vepruar ashtu, Pranuesi do t'i paguaj të gjitha kostot dhe shpenzimet (duke përfshirë tarifën dhe shpenzimet e arsyeshme të avokatit) të shkaktuara nga Banka në lidhje me një veprim apo procedurë të tillë.

Neni -12 RAPORTET

Pranuesi ndërmerr për të dorëzuar, apo do të shkaktoj që t'i dorëzohen Bankës raportet si në vijim:

- (i) Brenda 3 (tre) muajve pas Datës Efektive të Marrëveshjes dhe pas kësaj çdo tre muaj, një raport mbi progresin dhe implementimin e Kontratës në aso mënyre të cilën Banka mundet herë pas here ta saktësoj;

- (ii) Menjëherë pas lëshimit të Certifikatës Përfundimtare të Pranimit, por jo më vonë së 6 (gjashtë) muaj pas lëshimit të një Certificate të tillë, një raport përfundimi i një fushëveprimi të tillë dhe në aso hollësirash ashtu siç mund të kërkoj Banka arsyeshëm, për ndërtimin e Asetit dhe për operimin fillestar të Projektit;
- (iii) Një raport vjetor i auditimit nga auditori financiar i Projektit. Ky raport do të ofrohet gjatë tërë Periudhës së Zhvillimit dhe periudhës së pagesës të Çmimit të Ulur sipas kësaj Marrëveshjeje; dhe
- (iv) Ndonjë raport tjetër apo informatë të cilat Banka mundet herë pas here t'i kërkoj në mënyrë të arsyeshme.

Neni -13 HEQJE DORË

Dështimi i Bankës për të ushtruar apo mbrojtur ndonjë nga të drejtat e saj sipas kësaj Marrëveshjeje apo vonesa e saj në të njëjtën apo dështimi i saj për të ushtruar a mbrojtur ndonjë korrigjim që mund të jetë kundër Pranuesit apo vonesa e saj në të njëjtën, nuk do të paragjykoj të drejtën e tillë apo korrigjimi dhe nuk do të interpretohet si heqje dore nga një e drejtë e tillë apo korrigjim.

Neni -14 EFEKTIVITETI

Kjo Marrëveshje do të bëhet efektive nga Data Efektive e Marrëveshjes Istisna'a.

Neni -15 LIGJI MBIZOTËRUES – ZGJIDHA E MOSMARRËVESHJEVE

- 15.1 Kjo Marrëveshje do të drejtohet nga dhe do të interpretohet në përputhje me parimet e Sheriatit Islamik siç është shpallur nga Akademia Islamike Fiqh, e siç është shpallur në Standardet e Sheriatit e publikuar nga Organizata e Kontabilitetit dhe Auditimit për Institucionet Financiare Islamike (AAOIFI), dhe ashtu siç interpretohet nga Komiteti i Sheriatit të Bankës.
- 15.2 Secila mosmarrëveshje në mes të Palëve në këtë Marrëveshje dhe secila kërkesë nga secila Palë kundër Palës tjetër që del nga kjo Marrëveshje, e cila nuk mund të përcaktohet me Marrëveshje të Palëve brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftimit të dorëzuar nga njëra Palë tek tjetra, do t'i dorëzohet panelit të Arbitrazhit për një vendim përfundimtar dhe detyruet në përputhje me rregullat dhe procedurat e Qendrës Ndërkombëtare Islamike për Pajtim dhe Arbitrazh (IICRA), Dubai, në Emiratet e Bashkuara Arabe. Rregullat dhe procedurat e arbitrazhit të IICRA do të jenë në vend të ndonjë procedure tjetër për përcaktimin e mosmarrëveshjeve në mes të Palëve në këtë Marrëveshje apo ndonjë kërkesë nga ndonjë Palë kundër Palës tjetër që del nga kjo.
- 15.3 Nëse brenda 30 (Tridhjetë) ditëve pasi që kopja ligjore e vendimit t'i jetë dorëzuar Palëve, vendimi nuk respektohet, secila Palë mund të hyj në vendim, apo të inicioj një procedurë gjyqësore për të zbatuar vendimin, në ndonjë gjykatë me juridiksion kompetent kundër Palës tjetër, mund të zbatoj një vendim të tillë me ekzekutim apo mund të ndjek ndonjë mjet tjetër të përshtatshëm ligjor kundër Palës tjetër për zbatimin e vendimit apo të dispozitave të kësaj Marrëveshjeje.

- 15.4 Secila palë në këtë Marrëveshje pajtohet se secili vendim që jepet sipas kësaj marrëveshjeje kundër saj mund të ekzekutohet kundrejt fondeve (aseteve) të saj në secilin juridiksion. Palët në këtë Marrëveshje me anë të kësaj në mënyrë të parevokueshme heqin dorë nga ndonjë kundërshtim që mund të kenë për ndonjë padi, veprim apo procedurë gjyqësore që dalin nga apo në lidhje me zbatimin e vendimit të arbitrazhit sipas kësaj Marrëveshjeje, nëse është sjellë në ndonjë juridiksion në të cilën ata i kanë fondet (asetet), dhe me këtë edhe më tutje në mënyrë të parevokueshme heqin dorë nga ndonjë kërkesë që ndonjë padi e tillë, veprim a procedurë gjyqësore e sjellë në ndonjë juridiksion është sjellë në ndonjë forum të papërshtatshëm.
- 15.5 Deri në atë masë sa Pala në këtë Marrëveshje mund në ndonjë juridiksion të kërkojë për vete apo për asetet e veta imunitet nga padia, ekzekutimi, bashkëngjitja (qoftë në ndihmë apo ekzekutim, para vendimit apo vendimit apo ndryshe) apo procesit tjetër ligjor apo deri në atë masë sa që në ndonjë juridiksion të tillë imuniteti i tillë mund t'i atribuohet vetës apo asetëve të saj (qoftë se a është kërkuar a jo), Pala e tillë me këtë në mënyrë të parevokueshme pajtohet që të mos kërkojë dhe në mënyrë të parevokueshme heq dorë nga imuniteti i tillë.

Neni -16 BASHKËRENDIMI DHE NJOFTIMET

- 16.1 **Bashkërendimi:** Pranuesi me këtë cakton Ministrin e Financave si përfaqësuesin e autorizuar të Pranuesit (Përfaqësuesi i Pranuesit) për të gjitha çështjet sipas kësaj Marrëveshjeje dhe për të gjitha intencat dhe qëllimet pa kufizim; në përputhje me rrethanat:
- (i) Që të merret me Bankën dhe të jetë direkt përgjegjës për përmbushjen e obligimeve në detyrë për Pranuesin me anë të kësaj Marrëveshjeje.
 - (ii) Të gjitha komunikimet të secilit lloj që i jepen nga Banka Përfaqësuesit të Pranuesit do të konsiderohen se i janë dhënë siç duhet Pranuesit;
 - (iii) Të gjitha komunikimet që pranojnë nga Banka nga Përfaqësuesi i Pranuesit do të konsiderohen se janë dhënë apo janë bërë siç duhet, dhe janë pranuar nga Pranuesi; dhe
 - (iv) Përfaqësuesi i Pranuesit, gjatë gjithë kohës, do të zhvillojë një bashkërendim dhe bashkëpunim të duhur dhe efikas, dhe do të sigurojë se Pranuesi dhe Agjencioni Ekzekutues i zbatojnë detyrat e tyre këtu.
- 16.2 **Njoftimet:** Secili njoftim, aprovim, kërkesë apo komunikim tjetër që do të jepet apo do të bëhet sipas kësaj Marrëveshjeje apo në lidhje me këtë do të jetë me shkrim dhe do të konsiderohet se janë dhënë siç duhet kur dorëzohen me dorë, postë ajrore, me shërbim ndërlidhës të vendosur, apo me faksimil Palës së cilës i jepet në adresën e Palës që është saktësuar më poshtë apo në ndonjë adresë tjetër të tillë të cilën Pala do t'ia ketë përcaktuar me njoftim Palës që e jep njoftimin e tillë, kërkesën apo komunikimin.

Për Pranuesin:

Ministria e Financave
Rr. NënaTerezë, p.n. Prishtinë, 10000
Republika e Kosovës
Tel: +381 38 200 34 101

Fax: +381 38 213113
Email: zyraministrit@mfe-ks.org

Për Bankën:

P.O. Box 5925
Jeddah-21432
Mbretëria e Arabisë Saudite
Tel: +966 2 6361400
Fax: +966 2 6366871
Email: archives@isdb.org

Neni -17 TË NDRYSHME

- 17.1 Pjesa përshkruese dhe anekset janë pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje.
- 17.2 **Autoriteti:** Personi që e nënshkruan këtë Marrëveshje në emër të secilës Palë me këtë përfaqëson dhe i garanton palës tjetër se ai apo ajo e ka kompetencën e kërkuar ligjore dhe autoritetin për të ekzekutuar këtë Marrëveshje në emër të Palës dhe e detyron Palën ndaj obligimeve këtu.
- 17.3 **Kopjet ligjore:** Kjo Marrëveshje, duke i përfshirë amendamentimet, mund të ekzekutohet në kopjet ligjore të cilat kur merren së bashku do të përbëjnë një marrëveshje të vetme. Kopjet e kësaj Marrëveshjeje do të jenë barabartë të detyrueshme sa edhe origjinalet dhe nënshkrimet e kopjeve origjinale të dërguara me faks, apo të skanuara dhe të dërguara me email do të jenë të mjaftueshme për të dëshmuar ekzekutimin, ndonëse Palët mund të kërkojnë që t'u dorëzohen dokumentet e nënshkuara dhe origjinale.
- 17.4 **E tërë marrëveshja:** Kjo Marrëveshje është e tërë marrëveshja dhe e zëvendëson ndonjë marrëveshje tjetër paraprake me gojë a me shkrim apo komunikimet në mes të palëve në lidhje me temën në fjalë. Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje janë të ndara ashtu që nëse ndonjë dispozitë grindet se është jo valide, e paligjshme apo e pazbatueshme, një gjetje e tillë nuk do të ndikoj në vlefshmërinë, ndërtimin apo zbatueshmërinë e ndonjë dispozite të mbetur.
- 17.5 **Amendamenti:** Kjo Marrëveshje mund të amendamentohet vetëm me një marrëveshje të dyanshme me shkrim të palëve.
- 17.6 **Data e Marrëveshjes:** data e kësaj Marrëveshjeje, për të gjitha qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, do të jetë ajo që shfaqet në preambulë.

[FUNDI I NENEVE]

Faqja e ekzekutimit:

Në cilësinë e dëshmitarit, Palët, përmes përfaqësuesve të tyre të autorizuar siç duhet, e kanë nënshkruar këtë Marrëveshje që ka të bëjë me financimin e Asetit në lidhje me përmirësimin e projektit të Rrugës Kryesore M2 Milloshevë–Mitrovicë që nuk tejkalon €15,410.000.00 (Pesëmbëdhjetë Milion e Katërqind e Dhjetë Mijë Euro) përafërsisht që është ekuivalent me ID13,200,000.00 (Trembëdhjetë Milion e Dyqind Mijë Dinar Islamik) në datën e parë të shkruar.

PËR DHE NË EMËR TË
REPUBLIKËS SË KOSOVËS

BESIM BEQAJ
MINISTËR I FINANCAVE

PËR DHE NË EMËR TË
BANKËS ISLAMIKE PËR ZHVILLIM

DR. AHMAD MOHAMED ALI
PRESIDENT

Aneksi -I PËRSHKRIMI I ASETIT

1. Projekti është i vendosur në Rrugën 6 të korridorit transportues të rrjetit Observator të Transportit të Evropës Jug Lindore (SEETO). Ky përbëhet nga përmirësimi i Rrugës Kryesore M2 që e lidh Prishtinën, kryeqytetin, me dy qytete të mëdha, atij të Vushtrrisë dhe Mitrovicës në drejtim të Veri Perëndimit. Rruga e vetme ekzistuese më një kors në të dy anët do të përmirësohet në një rrugë të dyfishtë me dy kors në një distancë totale prej 26.7km, që fillon nga Millosheva, 8km nga Prishtina, deri në hyrje të Mitrovicës.

2. Pjesa e financuar e Bankës është 4.55km e gjatë dhe përbëhet në një anashkalim të qytetit të Vushtrrisë përgjatë një shtrirjeje të re që fillon 16.96km pas fillimit të punëve në Milloshevë, dhe duke përfunduar në dalje të qytetit të Vushtrrisë me një rreth për ndarjen e trafikut.

3. Kostoja totale e projektit është vlerësuar në Euro 87.04 milion duke mos i përfshirë tatimet e taksat doganore. Përveç Bankës dhe Pranuesit, Projekti është i bashkë financuar nga entitet tjera sipas dokumenteve të Projektit dhe sipas tabelës në vijim. Banka mbulon punët civile në 4.55 km të rrugës nga Km 16.95 deri në Km 21.51 e cila përbëhet nga një anashkalim të qytetit të Vushtrrisë dhe 100% të të gjitha komponentëve tjera (Shërbimet e Konsulencës, Mbështetje për Menaxhimin e Projektit, Funkcionalizmin e punëtorisë /familjarizimi dhe Auditimin Financiar) përveç për blerjen e tokës që mbulohet nga Pranuesi.

Tabela-1: Vlerësimi i Kostos së Projektit & Plani i Financimit

Sr. Nr	Komponentët e projektit	Banka		Bahja financuesit		Pranuesi		Kostoja totale
		€Mn	%	€Mn	%	€Mn	%	
A.	Blerja e tokës	-	-	-	-	14.00	100.0%	14.00
B.	Punët civile	11.79	18.7%	28.32	45.0%	22.79	36.2%	62.91
C.	Shërbimet e Konsulencës	1.77	100.0%	-	-	-	-	1.77
D.	Menaxhimi i Projektit	0.38	100.0%	-	-	-	-	0.38
E.	Funksionalizimi i punëtorisë/familjarizimi	0.03	100.0%	-	-	-	-	0.03
F.	Auditimi financiar	0.04	100.0%	-	-	-	-	0.04
	Kostoja bazë	14.01	17.7%	28.32	35.8%	36.79	46.5%	79.13
	Rezervat fizike	0.42	17.7%	0.85	35.8%	1.10	46.5%	2.37
	Çmimi i rezervave	0.98	17.7%	1.98	35.8%	2.58	46.5%	5.54
	Totali	15.41	17.7%	31.16	35.8%	40.47	46.5%	87.04

Komponentët e projektit janë si në vijim:

1. **Blerja e Tokës:** ky komponent përfshinë blerjen e të gjitha tokës së kërkuar dhe pasurisë së paluajtshme që është e nevojshme për përmirësimin e rrugës nga Qeveria e Kosovës, zhvendosja e shërbimeve publike dhe kompensimi i tokës dhe pronarëve të pasurisë në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 03/I-139, më datë 26.03.2010 “për Ekspropriimin e pasurisë së paluajtshme”. Kërkesat e vlerësuara kapin shumën prej 342,655 m² duke përfshirë 117,839m² të pasurisë private dhe 224,816m² të pasurisë shtetërore. Vlerësimi bruto i vlerës së tokës në pjesën që bashkë financohet nga Banka nga Millosheva deri në Vushtrri kap shumën prej €1 Milion.
2. **Punët Civile:** do t’i përfshijë të gjitha punët civile që kanë të bëjnë me përmirësimin e rrugës ekzistuese në një rrugë kryesore të dyfishtë me dy korsi në përputhje me standardet evropiane nga Lumi i Madh (PK7.165) deri në Mitrovicë (PK26.7). Artikuj kryesor të punës përfshijnë punët e dheut, shtresat e grimcuara të trotuareve, shtresat e stabilizuara, shtresa bituminoze, strukturat e mbajtjes, mure prej koshave me gurë, urave, kanaleve nën rrugë, sistemeve të drenazhit të pjesët anësore të rrugës, instalimit të mjeteve të sigurisë rrugore dhe punët e ndryshme. Dy korsit do të ndahen.
3. **Shërbimet e konsulencës:** Kompania e konsulencës do të kontraktohet për të performuar rishikimin e dizajnit të hollësishëm, përgatitjes së dokumenteve për tender për punët civile, për të asistuar Ministrinë e Infrastrukturës në vlerësimin e ofertave dhe për të zhvilluar mbikëqyrje të punëve në pjesën nga Lumi i Madh (PK7.2) deri në Vushtrri (PK21.5).
4. **Mbështetja për Menaxhimin e Projektit:** do të përfshijë shpenzimet dhe koston e publikimeve të dokumenteve të prokurimit të Njësisë për Menaxhimin e Projektit (NJMP) si vijon:
 - a) Shpenzimet e NJMP-së: përfshinë pagat e stafit të NJMP-së, kostot aktuale, dhe blerjen e pajisjeve të zyrës së NJMP –së (TI, mobile dhe dy automjete 4x4).
 - b) Kostoja e Njoftimit të Prokurimit të Përgjithshëm (NPP) dhe Njoftimit të Prokurimit të Veçantë (NPV), publikimeve për prokurimin e mallrave, punëve dhe shërbimeve, në një gazetë ndërkombëtare me tirazh të gjerë gjithashtu do të mbulohet nga Banka.
5. **Funksionalizimi i punëtorisë dhe vizita e familjarizimit,** për t’i mbuluar kostot e funksionalizimit të punëtorisë dhe vizitës së familjarizimit në IDB – HQ që do të organizohet për agjencionin ekzekutues dhe stafin kyç të NJMP-së në mënyrë që të trajnohen ata në procedurat e prokurimit dhe të disbursimit të Bankës.
6. **Auditimi Financiar i Projektit.** Një kompani lokale e auditimit me reputacion do të angazhohet për t’i audituar pasqyrat financiare të projektit dhe shfrytëzimin e alokimeve të buxhetit.